



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në:

“Anglisht”

Universiteti Privat Albanian University

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Elida TABAKU

Prof. As. Dr. Rudina VRIONI

Tetor/ 2025

Tabela e përgjithshme për programin e studimit, Bachelor në: Anglisht

1	IAL aplikues:	Universiteti privat Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Anglisht
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 199, datë 16.05.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR nr. 2600/1 prot., date 02.06.2021.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 631, datë 12.12.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 39 datë 12.03.2021
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit	2024-2025 : 5 PAE/1 PAK 2023-2024 : 4 PAE/ 1PAK 2022-2023 : 5 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2024-2025 9 studentë 2023-2024 1 student 2022-2023 8 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore në “Albanian University”.

Ky departament ka filluar funksionimin e tij në Albanian University në vitin 2010, dhe ofron tre programe Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Fillor”, “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe “Anglisht”. Gjithashtu ai ofron një program studimi Master Profesional në “Pedagogji” me dy profile “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimi” dhe një program studimi për formimin e vazhduar: “Çertifikatë për Formimin Psiko-Pedagogjik”.

Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 199, datë 16.05.2012. Ai u akreditua nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 39 dt.12.03.2021 për një periudhe prej 4 (katër) vitesh. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është 30/09/2025. Bordi i Akreditimit dha disa rekomandime për këtë program në lidhje me: përcaktimin e qartë të objektivave dhe kompetencave që fitojnë studentët në përfundim të këtij programi studimi, raport më të drejtë të lëndëve karakterizuese dhe të formimit të përgjithshëm në kurrikul, pasurimin e bibliotekës me kopje fizike të literaturës bazë në funksion të këtij programi studimi, zgjerimin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë për të rritur mundësitë e mobilitetit të stafit dhe studenteve, si dhe përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit me qëllim përshtatjen plotësisht të saj me nevojat e tregut të punës.

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ngriti një grup pune, rishikoi kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Anglisht”, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit si dhe përmirësimin e tij për t’u përshtatur sa më mirë me tregun e punës. Ndryshimet dhe përmirësimet përkatëse u miratuan nga Senati Akademik me vendim nr. 09 datë 07.04.2021 dhe iu dërguan MAS për miratim përfundimtar.

Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Programi përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë, konceptet dhe kompetencat në fushën e gjuhës angleze. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Programi ofron kualifikim të nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit në të për të vijuar studimet në programe të ciklit të dytë, në programet Master i Shkencave ose Master Profesional.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Dr. Elida Tabaku dhe Prof. Asoc. Dr. Rudina Vrioni, me mbështetjen e koordinatorës teknike të ASCAL Znj. Anilda Beqiraj. Ky grup është ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB), i hartuar nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur “Albanian University” për të përmbushur synimet si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është i shoqëruar nga një dosje evidencash, që mbështesin kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, në lidhje me rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programet dhe rezultatet e të nxënit, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij. Shkrimi i RVB reflekton profesionalizëm, kujdes në analizën e përmbushjes së standardeve dhe vëmendje në pasqyrimin konkret të gjetjeve në pjesën përshkuese. GVB reflektoi gjithashtu njohje të sa më sipër edhe gjatë intervistës me GVJ.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 14 dhe 15 Korrik 2025, GVJ organizoi takime me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrës së Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, si edhe me përfaqësues të Shërbimeve Bibliotekare.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorin, sallat e Internetit, etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij. Takimet u shoqëruan me diskutime dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program.

Universiteti është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 17.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 173/19, datë 17.10.2025. Institucioni njofton se nuk ka komente në ASCAL, më datë 22.10.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 370/1, datë 22.10.2025. Drafti kalon në raport final.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” ofruar nga Albanian University është akredituar për herë të fundit nga Bordi i Akreditimit me Vendim nr. 39, datë 12.03.2021, me vlerësim përfundimtar Pozitiv dhe me kohëzgjatje prej 4 vitesh deri më 30.09.2025.

Vendimi i Bordit të akreditimit është shoqëruar me disa rekomandime.

Në përmbushje të rekomandimeve Albanian University ka ndjekur disa hapa:

Programi është riorganizuar në masën nën 20% me Vendim Senati nr. 9, datë 07.04.2021, miratuar me shkresë MASR nr. 2600/1 prot., datë 02.06.2021.

Është percjellë plani i veprimit për përmbushjen e rekomandimeve me shkresë nr. 392 prot., datë 03.09.2021.

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 39, datë 12.03.2021 janë:

1. Institucioni të përcaktojë qartë në rregulloren e programit të studimit objektivat dhe kompetencat që fitojnë studentët në përfundim të këtij programi studimi.
2. Institucioni të marrë masa për shtimin e kopjeve fizike të literaturës bazë në funksion të këtij programi studimi.
3. Institucioni të ndryshojë statusin dhe ngarkesën e lëndëve të formimit psiko-pedagogjik në kurrikul, në mënyrë që të shmangë mundësinë e përsëritjes së këtyre njohurive nga një student që zgjedh të ndjekë ciklin e dytë në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe në mënyrë që t'u lërë më tepër hapësirë lëndëve/moduleve që ofrojnë njohuri më specifike të formimit gjuhësor, kulturor, stilistikor dhe analitik të gjuhës angleze.
4. Institucioni të zgjerojë kuadrin e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, për të rritur mundësitë e mobilitetit të stafit dhe studenteve, përditësimin të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve në programin në fjalë;
5. Institucioni të rikonstruktojë kurrikulën e programit të studimit, me qëllim përshtatjen plotësisht të saj me nevojat e tregut të punës.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Rekomandimi nr.1: Në fillim të vitit akademik 2021–2022 në zbatim të rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes rishikoi objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”. Kjo rregullore është rishikuar dhe aprovuar me Vendim Nr. 1 te Senatit Akademik, nr., protokoll 65, datë 31.01.2025.

Objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit Bachelor në “Anglisht” janë:

1. Të pajisë studentët me njohuri të gjera në gjuhën angleze, në fushat e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe përkthimit.
2. Të përgatisë profesionistë të aftë për të komunikuar në mënyrë efektive në gjuhën angleze, në kontekste të ndryshme akademike dhe profesionale.
3. Të nxisë zhvillimin e aftësive kritike, analitike dhe kërkimore të nevojshme për një përfshirje aktive në fushën e studimeve gjuhësore dhe kulturore.
4. Të zhvillojë kompetenca ndërkulturore për të komunikuar në mënyrë efektive me persona nga kultura dhe kombësi të ndryshme, veçanërisht në kontekste profesionale si turizmi, biznesi apo diplomacia
5. Të përgatisë studentët për të mësuar dhe dhënë mësim në gjuhën angleze në institucione arsimore private apo publike, sipas metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve të huaja.

b) Objektivat specifike për studentët:

1. Të kuptojnë dhe analizojnë struktura gjuhësore të gjuhës angleze në nivele të avancuara.
2. Të interpretojnë dhe kritikojnë tekste letrare dhe joletrare në anglisht.
3. Të zbatojnë parime të përkthimit dhe përshtatjes gjuhësore.
4. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të analizuar strukturën gramatikore dhe semantike të gjuhës angleze përmes një sërë kursesh teorike dhe praktike që zhvillohen
5. Të aftësojë studentët për të përkthyer dhe interpretuar me saktësi materiale nga gjuha angleze, duke marrë parasysh kontekstin kulturor dhe stilin e origjinalit.
6. Të përgatisë studentët për të përdorur teknologjitë moderne të gjuhës dhe përkthimit, si softuerët, korpuset gjuhësore dhe mjete digjitale për mësimdhënie.

Kjo kurrikul e riorganizuar pajis studentët me kompetenca gjuhësore, analitike dhe profesionale në gjuhën angleze, të nevojshme si për ata që do ndjekin studimet në ciklet pasardhëse ashtu edhe për tregun e punës.

Ky program është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), niveli 6, dhe objektivat e tij janë të pasqyruara në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Anglisht”.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht

Rekomandimi nr.2: Referuar vizitës në Institucion, takimit me stafin dhe syllabuseve të lëndëve vihet re se në fillim të çdo viti akademik përditësohet literatura bazë dhe ajo e rekomanduar, duke përfshirë libra dhe burime nga pesë vitet e fundit.



Çdo vit akademik, Departamenti i kushton një zë të veçantë buxhetit për blerjen e kopjeve fizike të teksteve bazë të programeve të studimit, duke siguruar kështu pasurimin e bibliotekës. Në kuadër të këtij procesi dhe me qëllim shtimin e titujve në bibliotekën e universitetit, Departamenti kryen blerje të librave për të pasuruar fondin e bibliotekës me kopje fizike.

Gjithashtu, për të përmbushur këtë rekomandim, lektorët e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes kanë dhuruar rreth 150 tituj librash të cilat i përkasin fushës së gjuhës angleze, me qëllim pasurimin e bibliotekës.

GVJ konstaton se kopjet fizike të librave në gjuhën angleze nuk janë të mjaftueshme për lëndët e këtij programi. Në bibliotekë nuk gjendeshin librat e përkrahur në shkresën e blerjeve datë 29. 10. 2024. (evidenca R.II.a)

Evidencë R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf

Evidencë nr. R.II.b - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf

Evidencë nr.R.II.c - Dhurimi i librave V.Tafani.pdf

Evidencë R.II.d. Dhurimi i librave nga Akademia e Shkencave te Shqiperise.pdf

GVJ vlerëson se ky rekomandim NUK është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi nr 3: Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ngriti grupin e punës dhe i rishikoi planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”. Ndyshimet e planit mësimor u miratuan me **Vendim Senati nr. 09 datë 07.04.2021**, Miratuar nga MAS me shkresë **nr. 2600/1Prot. datë 02.06.2021**. Në zbatim të rekomandimeve është riparë statusi dhe ngarkesa e lëndëve të formimit psiko-pedagogjik në kurrikul, për të shmangur përsëritjen e njohurive për studentët që zgjedhin të ndjekin ciklin e dytë në mësimdhënien e gjuhës angleze. Kurrikula e rishikuar mundëson zhvillimin e njohurive specifike gjuhësore, kulturore, stilistike dhe analitike, të cilat janë thelbësore për formimin akademik dhe profesional të studentëve. Përfshirja e lëndëve ose moduleve si Stilistikë, Analizë teksti II, Variante të Gjuhës Angleze, Anglisht Përmes Gjinive Letrare etj. synon arritjen më të plotë të objektivave të programit të studimit.

Evidencë nr.R.III.Procedura e rishikimit të planit mësimor.pdf

Evidencë nr.R.IV.a - Plani mësimor 2020-2021.pdf

Evidencë nr.IV.b - Plani mësimor 2024-2025.pdf

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi nr.4: Në zbatim të rekomandimeve të BA për zgjerimin e bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë Albanian University ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për të rritur mundësitë e mobilitetit të stafit dhe studenteve, përditësimin të infrastrukturës dhe rritjes së kapaciteteve në programin në fjalë;

Gjatë viteve akademike 2020-2025, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare bëri të mundur nënshkrimin e disa marrëveshjeve bashkëpunimi:

- Duke filluar nga viti akademik 2020-2021 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin **Kirchliche Pedagogische Hochschule Eien / Krems, “Albanian University”stri**. Në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar mobilitete për studentët dhe stafin akademik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Ky mobilitet ka vijuar për 4 vite akademike (2020-2024) dhe është rinovuar edhe për 4 vite akademike të tjera (2024-2028). [Evidencë R.V.b] . Konkretisht kanë zhvilluar mobilitetin: viti akademik 2021-2022 (2 studentë/3 staf akademik), viti akademik 2022-2023 (2 studentë/2 staf akademik), viti akademik 2023-2024 (3 studentë/3 staf akademik), viti akademik 2024-2025 (2 studentë/2 staf akademik) [Evidencë R.VI.a.b.c.d.e]
- Gjatë vitit akademik 2023-2024 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit midis Albanian University dhe **Afyon Kocatepe University, Turqi**, me synim kryesor zgjerimin e partnerëve ndërkombëtarë për bashkëpunim në projekte të përbashkëta, ofrimin e mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve. [Evidencë R. VII.a]
- Gjatë vitit akademik 2023-2024 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me **Polonia University, Poloni**, me të cilin stafi akademik dhe studentët do të kenë mundësi mobiliteti Erasmus+ .[Evidencë R.VII.b]
- Gjatë vitit akademik 2024–2025, Albanian University ka formalizuar një marrëveshje të re bashkëpunimi me **EU Innovation Hub**, e cila synon të forcojë partneritetet ndërkombëtare dhe krijon mundësi konkrete për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe përfshirjen aktive të studentëve në projekte të përbashkëta. [Evidencë R.VII.e]
- Është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me **Scoala Națională de Studii Politice și Administrative – SNSPA (National University of Political Studies and Public Administration)** në Rumani që synon të forcojë bashkëpunimin akademik dhe institucional ndërmjet dy palëve, duke krijuar mundësi për shkëmbime të ndërsjella në fushën e arsimit, trajnimeve profesionale, zhvillimit të kapaciteteve dhe pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta kërkimore e akademike. [Evidencë R.VII.f]
- Në kuadër të pjesëmarrjes në disa projekte ku Albanian University është partner, janë nënshkruar edhe disa marrëveshje bashkëpunimi si: **Virtual Exchanges, DU-AL dhe RES-UNI**. Në këto projekte janë

përfshirë studentë dhe staf akademik të Departamentit të Edukimit dhe të Anglishtes, të cilët janë angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e tyre. [Evidencë R.VII.h.i.j]

- Gjithashtu në kuadër të aplikimit në projekte kombëtare Albanian University është lidhur një marrëveshje specifike me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për aplikimin në projekte nga stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. [Evidencë R.VII.c]

- Në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore për programin e studimit Bachelor në “Anglisht”, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi çdo vit akademik me secilën prej Zyrave Vendore Arsimore, apo institucione të tjera ku studentët zhvillojnë praktikat mësimore. [Evidencë R.VII.d]

- Albanian University, konkretisht Fakulteti i Shkencave Shoqërore është partner në projektin **Horizon RESILIENCE**, ku kordinatorë është Përgjegjësjë e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes. Staf akademik dhe studentë të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes janë përfshirë në të. [Evidencë R.VII.k]

- Gjatë vitit akademik 2024–2025, **Shkolla e Drejtorëve (CSL)** ka realizuar programin e saj të trajnimeve pranë ambienteve të **Albanian University**, në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërinstitucional. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, u bë i mundur angazhimi i stafit akademik të universitetit në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve. Ky bashkëpunim ka shërbyer si një model i mirë për ndërthurjen e burimeve akademike me nevojat praktike të formimit profesional në fushën e arsimit. [Evidencë R.VII.l]

- Një marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar ndërmjet Albanian University dhe kompanisë ndërkombëtare **ELSEVIER**, e cila i mundëson institucionit akses në Scopus. Kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm në mbështetjen e kërkimit shkencor, duke u ofruar stafit akademik dhe studentëve mundësi për informim, hulumtim dhe publikim në përputhje me standardet ndërkombëtare. [Evidencë R.VII.m]

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim edhe me Zyrën e Marrëdhënive me Jashtë çdo vit akademik, punon për zgjerimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht

Evidencë R.V.a-Marrëveshja me KPH University 2020-2024.pdf

Evidencë nr. R.VI.a. Mobilitet KPH-2021-2022.pdf f

Evidencë nr. R.VI.b. Mobilitet KPH-2022-2023.pdf

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Evidencë nr. R.VI.c. Mobilitet 2023-2024.pdf
Evidencë nr. R.VI.d. Mobilitet KPH-2024-2025.pdf
Evidencë nr. R.VI.e. Mobilitet stafi akademik 2021-2025.pdf
Evidencë R.VII.d.1. ZVA.Tiranë 2020.pdf
Evidencë R.VII.d.2. Marrëveshja me ZVA Lushnje.pdf
Evidencë nr. RVII.d Marrëveshja ZVA Lushnje 2023.pdf
Evidencë R.VII.d.3. Marrëveshja me ZVA Krujë.pdf
Evidencë R.VII.e. EU Inovation HUB.pdf
Evidencë R.VII.f. Erasmus me Rumanine.pdf
Evidencë nr.RVII.h - Marrëveshja Erasmus Virtual.pdf
Evidencë nr.R.VII.i - Marrëveshja 2ALL.L.pdf
Evidencë nr.VII.j - Marrëveshje RES_UNI.pdf
Evidencë nr. R.VII.K Marrëveshja Horizon RESILIENCE.pdf
Evidencë nr. RVII. l - Marrëveshja me CSL- "Albanian University".pdf
Evidencë nr.R.VII.m - Marrëveshja me Elsevier.pdf

Rekomandimi nr.5: Albanian University ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në "Anglisht", me qëllim përshtatjen e saj të plotë me nevojat e tregut të punës. Në zbatim të rekomandimeve të BA, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka rishikuar dhe përmirësuar strukturën kurrikulare gjatë vitit akademik 2020–2021. Ky proces është bazuar në një analizë të tregut të punës, konsultime me ish-studentë të programit, punëdhënës në sektorë të ndryshëm si arsimit, përkthimi dhe komunikimi, si dhe me institucione partnere që bashkëpunojnë rregullisht me universitetin. Janë analizuar dhe marrë në konsideratë praktika ndërkombëtare të ndjekura nga universitete të njohura europiane dhe anglishtfolëse. Këto modele janë vlerësuar me kujdes, duke u përshtatur me kontekstin shqiptar për të garantuar që kurrikula e re të jetë si në përputhje me standardet ndërkombëtare, ashtu edhe e zbatueshme në praktikë. Plani i përmirësuar mësimor ofron fleksibilitet më të madh, zgjeron perspektivat e punësimit për studentët dhe përputhet me kompetencat që kërkon tregu i punës si dhe i përgatit për të vazhduar studimet në Ciklin e dytë . Zyra e Karrierës dhe Alumnit pranë "Albanian University" përgatit çdo vit një raport të detajuar mbi nivelin e punësimit të studentëve pas diplomimit.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur plotësisht

Evidencë nr. R. VIII- Analizë tregu i punës.pdf

Evidencë nr.R. IX.1 Gjurmimi i studentëve 2021-2022.pdf

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Anglisht”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” ofrohet në përputhje të plotë me vlerat akademike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë, në përcaktimet e Statutit dhe të Planit Strategjik të Albanian University, rregulloret përkatëse si dhe me misionin e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, si njësi kryesore e tij.</p> <p>GVJ nëpërmjet analizës së dokumentave vë re se programet e studimit të ciklit të parë në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes ofrojnë programe konkurruese, me tipare kombëtare dhe njëherazi të mbështetura edhe në traditën tonë më të mire, që synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Anglisht është organizuar me 180 kredite, pajis studentët me dije akademike dhe kompetenca të nevojshme për integrimin e tyre në tregun e punës dhe mundësimin e kontributit në fusha profesionale dhe ato të specialiteteve të gjuhës angleze në Shqipëri.</p> <p><i>Evidencë nr.I.1 Statut i “Albanian University”</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.2 -Strategji për zhvillimin Institucional të “Albanian University”.</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.5 - Rregullore e “Albanian University”.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.6 - Rregullore e FSHSH.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr II.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, njësi bazë në “Albanian University”, ka ndërtuar dhe ofron programin e studimit Bachelor në “Anglisht” në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Misioni i Programit të Studimit Bachelor në “Anglisht” përputhet plotësisht me qëllimet dhe misionin e “Albanian University” i cili është:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies; ▪ Të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit; ▪ Të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj; ▪ Të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese; ▪ Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës; ▪ Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal; ▪ Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore; <p>Kurrikula e programit dhe veprimtaritë e parashikuara mundësojnë realizimin e objektivave të përcaktuara nga institucioni.</p> <p><i>Evidencë nr.I.1 Statut i “Albanian University”.</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.2 -Strategji për zhvillimin Institucional të “Albanian University”</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.5 - Rregullore e “Albanian University”.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.6 - Rregullore e FSHSH.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr II.3- Rregullore e Departamentit te Edukimit dhe Anglishtes</i></p>
<p>Kriteri 3.Programi I studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Anglisht” ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të Albanian University, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit. Ai mbështet vizionin e universitetit për të qenë një qendër mësimore dhe kërkimore inovative, e orientuar drejt vlerave thelbësore njerëzore. Programi synon të kontribuojë në formimin e individëve të kualifikuar, profesionalë, të përgjegjshëm dhe të angazhuar në jetën shoqërore, të gatshëm për t’u përballur me sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së jetës në përputhje me nevojat kombëtare dhe rajonale.</p> <p><i>Evidencë nr.I.1 Statut i “Albanian University”.</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.2 -Strategji për zhvillimin Institucional të “Albanian University”</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.5 - Rregullore e “Albanian University”.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.I.6 - Rregullore e FSHSH.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr II.3- Rregullore e Departamentit te Edukimit dhe Anglisht</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën,</p>	<p>GVJ konstaton se “Albanian University” dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar</p>




<p>kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një program studimi në atë fushë.</p>	<p>programin e studimit Bachelor në "Anglisht". Ky departament në përbërje të tij ka si personel akademik efektiv në vitin 2024-2025</p> <p>12 PAE prej të cilëve:</p> <p>1 Prof.Dr., 5 Prof.Asoc.Dr, dhe 6 Dr.</p> <p>si dhe 16 PAK prej të cilëve:</p> <p>2 Prof.Dr., 5 Prof Asoc.Dr, 4 Dr. dhe 5 Msc..</p> <p>Referuar CV-ve të stafit akademik, GVJ konstaton se stafi është me përvojë akademike dhe i përshtatshëm për disiplinat e këtij programi studimi. Stafit akademik ka kualifikimin e duhur për formimin në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës .</p> <p>Gjatë vitin akademik 2024 -2025 , 70% e ngarkesës mësimore është mbuluar nga Personelit Akademik Efektiv dhe 30% nga Personel Akademik me Kontratë .</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka përvojën dhe kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore për ofrimin e programit të studimit Bachelor</p> <p><i>Evidencë nr.1.3 - CV Stafit akademik</i></p> <p><i>Evidencë – Tabelat, faqe 1-4</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme e programit të studimit, është në përputhje me fushën akademike e studimore të njësisë kryesore, Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Ky fakultet përbëhet nga tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politikko-Administrative • Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme • Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. <p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, është përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Ky Departament ofron edhe 2 programe të tjera Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor dhe Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor. Gjithashtu ai ofron një program studimi Master profesional në Pedagogji me Profil “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe “Menaxhim Arsimit”. Si dhe një program studimi për formimin e vazhduar “Çertifikatë për Formimin Psiko-Pedagogjik”.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” në formën e organizimit si dhe në strukturën dhe përmbajtjen e vet, i përmbahet fushave dhe drejtimeve akademike që përcakton Albanian University , të shprehura në planin strategjik dhe rregulloren e tij. Programi është në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e zhvillimit të “Albanian University” dhe me veprimtarinë akademike mësimore e kërkimore të njësisë bazë.</p> <p>Është bërë kodifikimi sipas udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, dhe ky Program Studimi ka kodin Bachelor në Anglisht 63BA0239S . Programi është projektuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, duke</p>




	siguruar që objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane. <i>Evidencë nr.1.4 - Shkresë për Kodifikimin e programit (1).pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Anglisht”, i ofruar nga “Albanian University”, është në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore.</i></p> <p><i>Ky program studimi ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që i përkasin të njëjtës fushë akademike me atë të programit, duke garantuar koherencë dhe cilësi në ofrim. Programi synon përgatitjen e specialistëve në fushën e gjuhës angleze, duke qenë një program konkurrues, me tipare kombëtare dhe i mbështetur në traditën më të mirë arsimore shqiptare. Një ndër objektivat kryesorë të tij është kontributi në ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore kombëtare.</i></p> <p><i>Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe infrastrukturore për ta menaxhuar programin në mënyrë efektive. Stafit akademik është me përvojë dhe i përshtatshëm për disiplinat specifike që përfshihen në këtë program.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1.Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve në programin e studimit Bachelor në “Anglisht” janë konceptuar për të garantuar përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Struktura e programit u ofron studentëve një bazë solide për ndjekjen e studimeve në nivelin Master, për integrimin efektiv

<p>aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>në tregun e punës, si dhe për përvetësimin e kompetencave të specializuara në fushën përkatëse.</p> <p>Emërtimi i lëndëve, objektivat e përcaktuara për secilën prej tyre, përmbajtja e veprimtarive mësimore, si dhe shpërndarja e balancuar e komponentëve teorikë dhe praktikë janë të ndërtuara në përputhje me objektivat e përgjithshëm të programit dhe me standardet e kualifikimit për nivelin përkatës. Kjo qasje synon të sigurojë një formim të gjithanshëm akademik dhe profesional, duke i përgatitur studentët si për studime të avancuara, ashtu edhe për angazhim të suksesshëm në fusha të ndryshme të tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektive formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve/modulëve, organizimi i tyre sipas viteve akademike dhe semestrave, si dhe vlerësimi në kredite ECTS, janë konceptuar në mënyrë që të mundësojnë arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin të studentëve.</p> <p>Lëndët janë organizuar në mënyrë të tillë që të ndjekin logjikën e zhvillimit të kompetencave përgjatë tre viteve të studimit, me synimin që formimi i studentit të jetë progresiv dhe i integruar. Në përfundim të ciklit të parë të studimeve, studentët arrijnë një profil të qartë akademik dhe profesional, për të qënë të aftë të ndjekin studimet në Ciklin pasardhës ose të përshaten me kërkesat e tregut të punës në fushën e gjuhës angleze.</p> <p>Ky program i ciklit të parë synon pajisjen e studentëve me njohuri të përgjithshme dhe specifike, si dhe me aftësi metodologjike bashkëkohore në fushën e përdorimit të gjuhës angleze në kontekste të ndryshme.</p> <p>Në vitin e parë akademik, programi fokusohet në formimin bazë dhe ndërdisiplinor, duke u ofruar studentëve njohuri të përgjithshme mbi fushën e studimit dhe duke krijuar themelet për një kuptim më të thellë të komponentëve gjuhësorë, kulturorë.</p> <p>Gjatë vitit të dytë dhe të tretë, theksi vihet në thellimin e njohurive specifike dhe zhvillimin e kompetencave praktike, që përputhen me profilin profesional të diplomës Bachelor në “Anglisht”. Në këtë fazë, studentët orientohen drejt lëndëve që lidhen ngushtë me përdorimin të gjuhës në nivel të përparuar; aftësitë për përkthim, përgatitje didaktike, dhe ndërveprim profesional. Kjo strukturë e studimeve siguron formimin e një eksperti të fushës, të aftë për të operuar në mënyrë autonome dhe të përgjegjshme në mjedise të ndryshme profesionale.</p> <p><i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3.Struktura e programit, lëndët, raporti</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është ndërtuar në përputhje me modelet kombëtare dhe ndërkombëtare të kësaj fushe, duke ndjekur</p>




<p>teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>standardet e Procesit të Bolonjës dhe duke respektuar raportin e balancuar ndërmjet përmbajtjes teorike dhe komponentëve praktikë.</p> <p>Struktura e programit është e konceptuar për t'i pajisur studentët me:</p> <p>Njohuri të thelluara gjuhësore; Aftësi komunikimi profesional në gjuhën angleze;</p> <p>Kompetenca të qëndrueshme për tregun e punës dhe për vijimin e studimeve në ciklet e mëtejshme .</p> <p>Gjatë tri viteve akademike (6 semestra), programi ofron një formim të integruar dhe të vazhdueshëm, si nëpërmes ruajtjes së raportit midis kategorive të lëndëve A-E, por nëpërmjet veprimtarive formuese të ndara si më poshtë:</p> <p>Leksione 1005 orë</p> <p>Seminare / Ushtrime 585 orë</p> <p>Detyra kursi / Laborator 100 orë</p> <p>Praktikë mësimore 161 orë</p> <p>Përgatitje për provim formimi / diplomë 161 orë</p> <p>Gjithsej në auditor 1851 orë</p> <p>Kjo strukturë siguron: Ngarkesë të balancuar për studentët në të gjithë semestrat;</p> <p>Zhvillim të qëndrueshëm akademik dhe profesional; Përgatitje për angazhim në fusha si mësimdhënie, përkthim, komunikim ndërkulturor, administratë, etj.</p> <p>Programi është i përputhshëm me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në nivelin 6, si dhe krahasueshëm me kurrikula të ngjashme të ofruara nga institucione të arsimit të lartë në Evropë, duke lehtësuar edhe mobilitetin akademik dhe profesional të studentëve brenda hapësirës evropiane të arsimit të lartë.</p> <p><i>Evidencë nr. II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e lëndëve sipas viteve akademike, semestrave dhe ngarkesës në kredite ECTS është konceptuar për të siguruar arritjen e objektivave formues të programit të studimit, si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit, të përcaktuara në kurrikulën përkatëse.</p> <p>Veprimtaritë formuese – nëpërmjet leksioneve, ushtrimeve/seminareve, praktikave, detyrave të kursit dhe përgatitjes së diplomës – lehtësojnë zhvillimin e kompetencave profesionale, si dhe mundësojnë mobilitetin akademik dhe punësimin pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Studentët, në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”, janë të aftë të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë, në programe të ngjashme, brenda ose jashtë vendit, si dhe të angazhohen profesionalisht në institucione publike ose private me karakter arsimor, gjuhësor, kulturor apo ndërkombëtar.</p>




	<p>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është i organizuar sipas pesë kategorive të veprimtarive formuese, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, dhe përmban këtë shpërndarje në kredite dhe përqindje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë bazë - Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) plotësojnë 30 ETCS ose 17 % të programit të studimit. • Lënde karakterizuese - Përgatitje për disiplinën shkencore (B) plotësojnë 101 ETCS ose 56 % të programit të studimit. • Lëndë ndërdisiplinore/integruese - Nëndisiplina, Profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) plotësojnë 23 ETCS ose 13 % të programit të studimit. • Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) plotësojnë 19 ECTS ose 11 % të programit të studimit. • Detyrime përmbyllëse (E) plotësojnë 7 ETCS ose 4 % të programit të studimit. <p>Kjo strukturë siguron koherencë midis objektivave të programit, ngarkesës akademike dhe përmbajtjes lëndore, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për përgatitjen e qëndrueshme akademike të studentëve; lehtësimin e transferimit të studimeve dhe integrimin në tregun e punës si dhe zhvillimin profesional në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, niveli 6.</p> <p><i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesen e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, GVJ evidentoi praktika të rregullta dhe të strukturuar të institucionit në lidhje me rishikimin e syllabuseve.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, institucioni ndërmerr një proces të rishikimit të përmbajtjes së syllabuseve dhe të programit të studimit. Ky proces përfshin diskutimin e nevojave për ndryshime dhe përmirësime brenda kuadrit të përcaktuar ligjor dhe institucional për modifikimet vjetore.</p> <p>Rishikimi i syllabuseve fokusohet në këto aspekte kryesore: Përditësimi i tematikave me qëllim përfshirjen e risive akademike dhe shkencore në secilën lëndë të planit mësimor; Rishikimi i literaturës së detyruar dhe ndihmëse, duke u bazuar në botime të viteve të fundit, si nga autorë vendas ashtu edhe të huaj, në përputhje me profilin specifik të çdo lënde.</p> <p>Biblioteka e institucionit pasurohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, në funksion të këtyre përditësimeve të syllabuseve, për të siguruar aksesin e studentëve dhe stafit akademik në literaturë bashkëkohore dhe relevante.</p> <p><i>Evidencë R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i> <i>Evidencë nr.II.9. - Procedurë e rishikimit të syllabuseve.pdf</i> <i>Evidencw nr.R.III.Procedura e rishikimit te planit mesimor.pdf</i> <i>Evidencë R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i></p>




<p>Kriteri 6.Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programet lëndore të këtij programi studimi përditësohen dhe përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke iu referuar literaturës bashkëkohore të detyruar dhe ndihmëse, të botuar në vitet e fundit. Këto përditësime synojnë të reflektojnë zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse dhe të sigurojnë një përputhje të vazhdueshme me kërkesat akademike dhe profesionale të tregut të punës. Programi studimor ka të përcaktuara qartë objektivat e përgjithshëm dhe ato specifike, të cilat orientohen drejt formimit të plotë të studentëve në fushën e gjuhës angleze dhe të aplikimeve të saj.</p> <p>Struktura e programit, raporti teori praktike, qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi në përputhje me objektivat kryesore të programit të studimit sigurojnë arritjen dhe përfitim e kompetencave të synuara.</p> <p>Ky program synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në gjuhën angleze, në fushat e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe përkthimit, duke i përgatitur ata për komunikim efikas në kontekste të ndryshme profesionale dhe akademike. Ai nxit zhvillimin e aftësive kritike, analitike dhe kërkimore, si dhe të kompetencave ndërkulturore për të operuar në mjedise shumëgjuhëshe, si turizmi, diplomacia dhe biznesi.</p> <p>Ndërsa objektivat specifike përfshijnë kuptimin dhe analizën e strukturave të avancuara të gjuhës, interpretimin kritik të teksteve, zbatimin e parimeve të përkthimit dhe përdorimin e mjeteve teknologjike moderne në mësimdhënie dhe përkthim.</p> <p>Në takimin me studentët e vitit të parë (viti i vetëm aktiv aktualisht), u evidentua vlerësimi i lartë i tyre për stafin akademik, duke theksuar kompetencën profesionale, përkushtimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që marrin gjatë studimeve.</p> <p><i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7.Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”, studentët pritet të kenë përvetësuar njohuritë, konceptet dhe kompetencat thelbësore për të ndjekur studimet e mëtejshme në ciklin Master, si dhe për të qenë të përgatitur për sfidat e tregut të punës në fusha të ndryshme që lidhen me gjuhën angleze.</p> <p>Programi synon të sigurojë jo vetëm njohuri akademike të thelluara, por edhe zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale, duke përfshirë komunikimin ndërkulturore, përkthimin, interpretimin, mësimdhënien dhe përdorimin e teknologjive të reja në fushën e gjuhës.</p> <p>Albanian University ofon një strukturë të qartë për udhëheqjen dhe kujdestarinë studentore, duke vendosur në qendër të vëmendjes mbështetjen akademike dhe profesionale të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e programit të mentorimit, i cili ka si qëllim: Mbështetjen e studentëve në aspektin profesional dhe akademik; Orientimin e tyre në planifikimin e karrierës;Ofrimin e njohurive për aspekte konkrete të</p>




	<p>profesioneve përkatëse, përfshirë strukturën organizative, kërkesat ligjore dhe përgjegjësitë që lidhen me profesionin.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” është ndërtuar në mënyrë të tillë që të garantojë përfitimin e dijeve teorike të qëndrueshme në fushat e gjuhësisë, letërsisë, përkthimit dhe mësimdhënies, e aftësive praktike në përdorimin e gjuhës dhe mjeteve bashkëkohore dhe kompetencave profesionale që përmbushin standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë nr. R.1- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.1.6 - Rregullore e FSHSH.pdf</i></p>			
Konkluzion	<p><i>GVJ konstaton se lëndët përbërëse të programit janë në përputhje të plotë me qëllimet dhe objektivat e tij formues. Ato janë të shpërndara në mënyrë të balancuar përgjatë viteve të studimit, duke siguruar përvetsim të njohurive, përgatitje për tregun e punës si dhe vijimësinë në studime të mëtejshme në ciklet e tjera.</i></p> <p><i>Struktura e programit, raporti ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikës, si dhe përfshirja e praktikës profesionale, kontribuojnë në përftimin efektiv të kompetencave të synuara nga programi. Metodot e vlerësimit janë të dizajnuara në përputhje me rezultatet e të nxënit dhe sigurojnë një vlerësim të drejtë dhe të gjithanshëm të përparimit të studentëve.</i></p> <p><i>Programi evidentohet si i krahasueshëm me programe të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, çka u jep studentëve mundësi të favorshme për transferimin e studimeve, në përputhje me kuadrin kombëtar dhe atë evropian të kualifikimeve.</i></p> <p><i>Programi i studimit Bachelor në “Anglisht” përditësohet në mënyrë të rregullt çdo vit, bazuar në diskutimet dhe analizat e zhvilluara brenda departamentit përkatës. Ky proces përditësimi pasqyrohet qartë në syllabuset, të cilat përmirësohen vazhdimisht me literatura bashkëkohore të publikuara në 5 vitet e fundit dhe me tematika të reja dhe risi të fushës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut	Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin dhe zhvillimin e programeve të studimit, duke i orientuar ato në funksion të kërkesave të tregut të punës. Në këtë kuadër, DEA zhvillon studime periodike të tregut të punës, me qëllim

<p>të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu I punës.</p>	<p>identifikimin e nevojave aktuale dhe në zhvillim të sektorëve përkatës; marrjen e informacionit për përmirësimet kurrikulare të programeve ekzistuese.</p> <p>Një komponent i rëndësishëm i përmirësimit të vazhdueshëm vjen nga vlerësimi që bëjnë vetë studentët, përmes pyetësorëve të strukturuar të zhvilluar në fund të çdo semestri nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë . Ky proces i rregullt monitorimi dhe vlerësimi përqendrohet në cilësinë e mësimdhënies; ndërveprimin ndërmjet pedagogëve dhe studentëve; literatura dhe burimet didaktike të përdorura; metodat dhe teknikat e vlerësimit;</p> <p>Të dhënat e mbledhura përmes këtyre vlerësimeve analizohen nga NJSBC dhe shërbejnë si bazë për marrjen e masave konkrete për përmirësim, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së përgjithshme të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr.I.1 Statut i “Albanian University”.</i></p> <p><i>Evidencë nr.VI.3. Model pyetësori M.Forms.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.VI.4 - Raport vjetor NJSBC 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.III.8- Pyetësori i studenteve v.a 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në “Albanian University”, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Siç u konstatua edhe gjatë takimeve të zhvilluara nga GVJ, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje nuk kufizohet vetëm në përfaqësimin formal.Institucioni nxit dhe mbështet përfshirjen aktive të studentëve në mbledhjet e Departamentit; ne mbnledhjet e Senatit Akademik dhe në Këshillin Studentor. Gjithashtu zhvillohen takime me studentë të diplomuar, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe përputhjen e tyre me realitetin e tregut të punës. Institucioni, përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe në bashkëpunim me njësitë akademike dhe drejtuesit e departamenteve, zhvillon procese të rregullta të feedback-ut dhe konsultimit me partnerë strategjikë akademikë dhe institucionalë dhe përfaqësues të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e</p>	<p>Institucioni mban kontakte të vazhdueshme me aktorë të ndryshëm në fushën e gjuhëve të huaja, me qëllim ndjekjen e përvojave bashkëkohore në mësimdhënie dhe ofrimin e programeve të përditësuara, të cilat janë të harmonizuara me modelet më të mira të mësimin të gjuhëve të huaja; nevojat konkrete të tregut të punës.</p> <p>Në procesin e rishikimit të kurrikulave të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (DEA), janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm në fushën e gjuhës angleze, të cilët kontribuojnë me njohuritë dhe përvojën e tyre akademike dhe profesionale; me vlerësim objektiv të përputhshmërisë së përmbajtjes kurrikulare me standardet dhe tregun e punës si dhe me</p>




<p>mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>sugjerime për përfshirjen e risive metodologjike dhe teknologjike në procesin mësimor.</p> <p>Në politikën e tij të zhvillimit DEA mbështetet në Planin Strategjik Institucional të “Albanian University” dhe Planin Strategjik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes (DEA).</p> <p>Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së programeve të studimit, departamenti ka hartuar dokumentin “Analiza e tregut të punës”, i cili reflekton konsultimet me bashkëpunëtorët dhe partnerët institucionalë; merr parasysh propozimet e aktorëve të jashtëm, që kanë lidhje të drejtpërdrejta me funksionimin dhe realizimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr.I.2.-Strategji per zhvillimin Institucional te ALBANIAN UNIVERSITY.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.II.11- Plani Strategjik DEA.pdf</i></p>
---	---

<p>Konkluzion</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes (DEA) zhvillojnë një proces të strukturuar konsultimi me aktorë nga tregu i punës dhe ai akademik, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”.</i></p> <p><i>Ky proces përfshin konsultime të rregullta me ish-studentë (alumni) të diplomuar në këtë program, të cilët ofrojnë vlerësime të vlefshme mbi përgatitjen e marrë dhe lidhjen e saj me realitetin profesional; marrjen e feedback-ut nga studentët aktualë, përmes pyetësorëve dhe diskutimeve të hapura, për të identifikuar nevoja për përmirësim, sidomos në komponentët praktikë të formimit; pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në komisione akademike, ku ata kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre lidhur me përmbajtjen dhe zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe DEA i japin një rëndësi të madhe bashkëpunimit me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve të tij. Bazuar në informacionin që vjen nga ky bashkëpunim bëhet përshtatja dhe përditësimi i programit.</i></p> <p><i>Kjo qasje e hapur dhe gjithëpërfshirëse siguron që programi i studimit Bachelor në “Anglisht” të jetë dinamik, bashkëkohor dhe i orientuar drejt tregut të punës, duke reflektuar zhvillimet më të fundit akademike dhe profesionale.</i></p>
--------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushje së Standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Email: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1.Programi I studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Gjuhë "Angleze" është ndërtuar në përputhje me kërkesat e rregulloreve në fuqi. Ky plan përfshin lëndë teorike dhe praktike të zhvilluara në gjuhën angleze, dhe përmbyllet me punimin e temës së diplomës ose me provimin e formimit profesional, si formë përmbyllëse të ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Programi ka si qëllim kryesor përgatitjen e specialistëve të fushës së gjuhës angleze, të aftë për të përvetësuar dhe zbatuar njohuritë e fituara në kontekste të ndryshme profesionale. Objektivi i programit është që studentët të zhvillojnë aftësi interpretuese, analitike dhe praktike, duke siguruar një formim të plotë akademik dhe profesional.</p> <p>Struktura e programit është e ndarë si më poshtë:</p> <p>Viti i parë akademik përqendrohet në ofrimin e njohurive të përgjithshme, të mbështetura në lëndë themelore të karakterit shkencor dhe gjuhësor;</p> <p>Dy vitet pasuese synojnë thellimin e njohurive në përputhje me profilin profesional të diplomës "Bachelor në Anglisht", me fokus të veçantë në zhvillimin e kompetencave për përfshirje në institucione të ndryshme që operojnë në këtë fushë.</p> <p>Gjithashtu, kurrikula është ndërtuar për të përmbushur dy objektiva të rëndësishëm:</p> <p>Të përgatisë studentët për tregun e punës, duke i pajisur me kompetenca të nevojshme profesionale dhe gjuhësore;</p> <p>Të mundësojë vijueshmërinë e studimeve në ciklet e tjera të arsimit të lartë, në nivelin Master ose më tej, në fushat e gjuhës, përkthimit, mësimdhënies apo studimeve kulturore.</p> <p>Në përfundim të programit, studentët pritet të kenë zhvilluar kapacitete analitike, konceptuale dhe praktike, të domosdoshme për të ushtruar profesionin si njohës të avancuar dhe përdorues të gjuhës angleze në nivele të ndryshme.</p> <p><i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i> <i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2 .Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Përfshirja e lëndëve të tilla si Shprehi Komunikimi, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Gjuhë e Huaj – Frëngjisht, Të Folurit Publik, si dhe qasje ndërdisiplinore në programin e studimit, kontribuon në formimin e një profesionisti të kompletuar. Këto lëndë nuk synojnë vetëm përgatitjen e studentit si njohës dhe përdorues kompetent i gjuhës</p>




	<p>angleze, por edhe si një individ me aftësi të zhvilluara humane, sociale dhe komunikuese.</p> <p>Kjo qasje shumëdimensionale e kurrikulës i ofron studentit mundësinë për të zhvilluar aftësi të avancuara në të folurit publik, ndërtimin e argumentit, komunikimin ndërkulturor dhe ndërveprimin profesional, të cilat janë të domosdoshme në kontekste të ndryshme pune, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu, detyrat e kursit të shpërndara përgjatë gjithë ciklit të studimeve Bachelor, përfshirë raportet me shkrim dhe prezantimet me PowerPoint, shërbejnë si një mjet i drejtpërdrejtë për zhvillimin e kompetencave komunikuese dhe ndërvepruese të studentëve. Këto aktivitete kontribuojnë në formimin e një profili studentor të aftë për të artikuluar ide në mënyrë të qartë, për të prezantuar punën e tij para audiencës dhe për të bashkëpunuar në mjedise profesionale dhe akademike.</p> <p><i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.II.1 - Plani mësimor 2024-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3.Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar takimeve me stafin akademik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se studentët orientohen në mënyrë të qartë dhe të strukturuar lidhur me strukturën dhe natyrën e pyetjeve të provimit përfundimtar, si dhe peshën e secilit komponent vlerësimi në notën përfundimtare të modulit.</p> <p>Syllabuset e çdo lënde përmbajnë informacion të detajuar mbi:</p> <p>Qëllimet dhe rezultatet e të nxënit;</p> <p>Kompetencat dhe aftësitë që studenti do të fitojë gjatë ndjekjes së modulit;</p> <p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret përkatëse.</p> <p>Vlerësimi i këtyre kompetencave realizohet gjatë gjithë semestrit përmes detyrave të kursit, punëve praktike, pjesëmarrjes aktive në seminare dhe ushtrimeve të kontrollit të njohurive.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde, pedagogu organizon një seancë përmbledhëse orientuese, gjatë së cilës bëhet rishikimi i tematikave kryesore, diskutimi i koncepteve kyçe dhe ofrohet udhëzim për përgatitjen e provimit final. Studentët gjithashtu dorëzojnë detyrat përkatëse të kursit dhe marrin pjesë në seanca vetëvlerësimi dhe ushtrime praktike, që i ndihmojnë të kuptojnë nivelin e përgatitjes së tyre.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri stafi akademik harton një raport semestral, ku reflekton mbi realizimin e objektivave të mësimdhënies, vlerësimin e progresit të studentëve dhe sfidat e hasura gjatë procesit mësimor. Përgjegjësi i departamentit përgatit një raport vlerësimi të përgjithshëm, i cili përfshin analizën e performancës së stafit akademik, përmbylljen</p>




	<p>e objektivave të planifikuara, si dhe nevojat për përmirësim apo masa të nevojshme për zhvillim të mëtejshëm të programit.</p> <p><i>Evidencë nr.III.1 - Raport Semestral DEA</i> <i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf"</i></p>
<p>Kriteri 4.Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Anglisht” është projektuar në mënyrë të integruar, duke kombinuar formimin teorik me praktikën mësimore, seminarët, ushtrimet, dhe praktikën profesionale në vitin e tretë të studimeve. Kjo qasje synon zhvillimin e kompetencave gjuhësore, pedagogjike dhe ndërkulturore, si dhe aftësive analitike, kritike dhe komunikuese, të cilat janë thelbësore për një formim profesional në fushat e mësimdhënies, përkthimit dhe interpretimit.</p> <p>Pjesë përbërëse e procesit mësimor janë detyrat e kursit, të cilat shpesh realizohen në formë grupore, me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit, ndarjes së përgjegjësisë dhe zhvillimit të aftësive për punë ekipore dhe debat konstruktiv.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes mbështet aktivisht përfshirjen e studentëve në projekte kreative, detyra kursi, tema diplome dhe prezantime publike. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në konferenca studentore, si dhe të kontribuojnë në revistën shkencore të universitetit “Optime” https://albanica.al/optime/article/vieë/219/165].</p> <p>Institucioni vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme, laboratorët dhe mjetet didaktike për realizimin e suksesshëm të këtyre projekteve, si dhe nxit përfshirjen e studentëve në aktivitete prezantuese dhe konkurruese.</p> <p>Mësimdhënia në këtë program kombinohet me përvojën praktike, ku studentët kanë mundësinë të zbatojnë në praktikë njohuritë e përfutuara përmes seminareve dhe praktikës profesionale, një komponent i dedikuar në programin e studimit. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me institucione publike dhe private, duke i ekspozuar studentët ndaj situatave reale të punës.</p> <p>Gjatë vitit akademik, lektorët dhe asistentët organizojnë orë të hapura mësimore, seminare me tema aktuale, dhe aktivitete ekstrakurrikulare, të cilat shërbejnë si platformë për zhvillimin profesional të studentëve.</p> <p>Në funksion të ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto bashkëpunime kanë mundësuar shkëmbime të suksesshme akademike në kuadër të programeve Erasmus+, duke rritur cilësinë e formimit dhe ekspozimin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Shënim:</p>




	<p>Gjatë shqyrtimit të planeve lëndore GVJ konstaton se ka plan të detajuar për praktikën profesionale të përqëndruar në MESUESI, kur ky program Bachelor nuk përgatit mësues të gjuhës angleze. Nuk parashikohet praktike profesionale në institucione të tjera, për të mundësuar pajisjen e studentëve me aftësi në përdorimin e gjuhës dhe në ndërveprim.</p> <p><i>Evidencë nr.III.2- Orët e hapura.pdf</i> <i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i> <i>Evidence nr. R.VI.a. Mobilitet KPH-2021-2022.pdf</i> <i>Evidence nr. R.VI.b. Mobilitet KPH-2022-2023.pdf</i>.<i>Evidencë nr. R.VI.c. Mobilitet 2023-2024.pdf</i> <i>Evidence nr. R.VI.d. Mobilitet KPH-2024-2025.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.VI.e. Mobilitet stafi akademik 2021-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5.Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë structures së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për programin e studimit në “Gjuhë Angleze”, organizojnë në mënyrë periodike aktivitete shtesë akademike, si: leksione të hapura, trajnime, orë informuese dhe seminare tematike.</p> <p>Këto aktivitete shërbejnë si një vlerë e shtuar në procesin mësimor, duke ofruar mundësi për thellim të njohurive përtej kurrikulës. Ato zhvillohen si nga personeli akademik i brendshëm, ashtu edhe nga të ftuar të jashtëm, të cilët janë specialistë të fushave të gjuhëve të huaja, përkthimit, interpretimit, arsimit, diplomacisë apo fusha të tjera të ndërlidhura.</p> <p>Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të sjellin perspektiva të ndryshme profesionale, të pasurojnë përvojën akademike të studentëve dhe t'i njohin ata me zhvillimet bashkëkohore dhe aplikimet praktike të njohurive të fituara gjatë studimeve.</p> <p><i>Evidencë nr.III.2- Orët e hapura.pdf</i> <i>Evidencë nr. I.10.a - Leksion i hapur Education for all.pdf</i> <i>Evidencë nr. I.10.b - Leksion i hapur.pdf</i> <i>Evidencë nr.I.10.c-Leksion i hapur.pdf</i></p>
<p>Konkluzion</p>	<p><i>Njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme në rritjen e cilësisë akademike dhe profesionale, duke organizuar takime, seminare, ëorkshop-e dhe aktivitete të tjera mbështetëse. Këto veprimtari zhvillohen në kuadër të bashkëpunimeve me institucione të ndryshme dhe kanë për synim motivimin dhe orientimin e studentëve drejt tregut të punës.</i></p> <p><i>Programi i studimit është konceptuar në përputhje me qëllimet që synon, duke integruar lëndë teorike dhe praktike që krijojnë të gjitha parakushtet për formimin e kompetencave të nevojshme për punësim, si dhe për vijimin e studimeve në ciklet e mëtejshme. Në përfundim të çdo</i></p>




	<p><i>lënde, stafi akademik realizon vlerësimin e nivelit të përvetësimit të kompetencave të përcaktuara në syllabus, duke analizuar rezultatet e arritura në raport me objektivat e parashikuara. Konkluzionet e nxjerra nga analizat në grupet lëndore dhe në nivel departamenti përdoren për përmirësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të programit të studimit.</i></p> <p><i>Gjithashtu, në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme, personeli akademik organizon leksione të hapura dhe orë mësimore interaktive, duke i ofruar studentëve mundësi të shtuara për përfshirje aktive në procesin mësimor dhe për thellimin e njohurive në fusha me interes të veçantë.</i></p> <p><i>Në përputhje me rregulloret në fuqi, departamenti ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët përgjatë gjithë procesit mësimor, duke vënë në dispozicion mjetet, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme për një përvojë akademike cilësore. Studentët inkurajohen dhe mbështeten në mënyrë aktive për të marrë pjesë në konferenca të organizuara nga Universiteti/Fakulteti, si dhe në konferenca studentore që synojnë zhvillimin akademik, prezantimin e punimeve kërkimore dhe shkëmbimin e përvojave mes bashkëmoshatarëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse në Albanian University dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale në lidhje me detyrimet përmbyllëse. Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes harton një fond pyetjesh orientuese, me qëllim përgatitjen dhe orientimin e studentëve që zgjedhin përmbylljen e ciklit me provimin e përgjithshëm të formimit.</p> <p>Studentët që ndjekin këtë formë diplomimi udhëzohen përmes seancave të posaçme orientuese, ku njihen me strukturën, natyrën dhe temat që përfshin fondi i pyetjeve të provimit.</p> <p>Ndërkohë, studentët që përzgjedhin përmbylljen e ciklit me punimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës, udhëhiqen gjatë gjithë procesit nga pedagogu udhëheqës dhe referohen në një manual të posaçëm për punimin e diplomës, i miratuar nga Departamenti.</p> <p>Të dy grupet e studentëve – si ata që ndjekin provimin e formimit, ashtu edhe ata që realizojnë temë diplome – mbështeten nga baza e dokumentacionit dhe materialeve ndihmëse të përgatitura nga</p>




	<p>Departamenti, duke garantuar transparencë, qartësi procedurale dhe mbështetje të vazhdueshme përgjatë procesit të diplomimit.</p> <p><i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.III.16 - Manuali për punimin e temës së diplomës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Anglisht”, komisioni i ngritur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja harton tezën për provimin final, bazuar në njohuritë e përfuara nga studentët gjatë tre viteve akademike. Përgatitja e tezës bazohet në fondin e pyetjeve të publikuara më parë për studentët, duke siguruar që temat dhe pyetjet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe nivelin e programit.</p> <p>Provimi i formimit përfshin testimin e njohurive të fituara nga studentët në të gjitha lëndët/modulet përkatëse, duke marrë parasysh rëndësinë dhe peshën specifike të secilës në kuadër të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët ndihmohen nga stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes gjatë përgatitjes për provimin e formimit, duke vënë në dispozicion materialet e nevojshme mësimore dhe duke rikujtuar temat e propozuara që janë trajtuar përgjatë zhvillimit të lëndëve gjatë ciklit Bachelor. Kjo mbështetje synon garantimin e përgatitjes sa më të mirë të studentëve për këtë provim përmbyllës.</p> <p>Udhëheqësi i temës së diplomës ka detyrimin të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme punën e studentit gjatë gjithë periudhës së hartimit të temës. Ai ofron udhëzime lidhur me metodologjinë e kërkimit, përzgjedhjen e literaturës mbështetëse, strukturimin dhe përmbajtjen e tezës së diplomës, si dhe mënyrën e prezantimit të saj përpara komisionit.</p> <p>Departamenti përcakton dhe afishon një grafik të detajuar të kontrolleve të temës së diplomës, ku pasqyrohen fazat e ecursë së punës dhe afatet për përmbylljen e tyre. Këto kontrolle janë të detyrueshme. Mos bërja e këtyre kontrolleve sipas kalendarit përkatës sjell humbjen e së drejtës për t’u paraqitur në sesionin e parë të diplomimit. Në këto raste, studenti mund të paraqitet vetëm në sesionet pasardhëse, pasi të ketë përmbyllur detyrimet e lëna pezull.</p> <p>Në përfundim të punimit të diplomës, përpara dorëzimit zyrtar të saj, udhëheqësi i diplomës harton një vlerësim përmbyllës, i cili i dorëzohet komisionit përfundimtar të vlerësimit, bashkë me dokumentacionin përkatës mbi ecurinë e punës nga ana e studentit .</p> <p>Po ashtu, tema e diplomës i nënshtrohet vlerësimit të një oponenti, i cili përcaktohet nga drejtuesi i Departamentit. Oponenti paraqet një vlerësim të pavarur dhe objektiv të punimit.</p>




	<p><i>Evidencë nr.III.17 - Formular udhëheqësi.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.III.18 - Formular Oponenti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5.Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni vendos në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në “Anglisht” fondin e bibliotekës së “Albanian University”, si dhe mjediset përkatëse të fakultetit, të tilla si laboratorët, salla të specializuara dhe hapësirat e studimit. Këto ambiente mund të përdoren nga studentët dhe nga stafi akademik i Departamentit për realizimin e detyrimeve akademike dhe kërkimore të lidhura me përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Në funksion të përgatitjes së diplomës, studentëve u ofrohet mbështetje për përdorimin e burimeve bibliografike, pajisjeve kompjuterike, si dhe për punën me të dhëna tabelare, grafike dhe analiza statistikore, në përputhje me kërkesat e metodologjisë së studimit apo natyrën e projektit të diplomës. Përdorimi i këtyre burimeve është i organizuar dhe i mbështetur nga njësia përkatëse, në mënyrë që të garantohet përmbushja cilësore e detyrimeve përfundimtare të ciklit të studimit.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Ky vlerësim dokumentohet në procesverbalet përkatëse, të cilat depozitohen në sekretarinë mësimore dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit përgjegjës: komisioni që harton tezën për provimin formues, ose komisioni i diplomimit për rastet e mbrojtjes së diplomës me temë. Rezultati përfundimtar i reflektuar në procesverbal bëhet publik në përfundim të secilës seancë mbrojtjeje dhe i komunikohet drejtpërdrejt studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr. III.19 - Diploma.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr.III.3- Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7.Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të këtij programi studimi, pasi studenti ka përmbushur të gjitha detyrimet akademike, ai pajiset me diplomën dhe suplementin përkatës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit . Diploma, si dokument zyrtar, plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nënshkruhet nga Dekani dhe nga Rektori i Universitetit Albanian University. Për secilin prej tyre, në dokument shënohen emri, mbiemri, grada akademike dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet gjithashtu me vulën zyrtare të universitetit.</p> <p><i>Evidencë nr.III.3-Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Bazuar në Raportin Vlerësimi të Brendshëm dhe gjatë vizitës në institucion, konstatohet se dokumentacioni i studentëve gjatë studimeve arkivohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, u vu re një organizim i mirë i arkivës dhe i materialeve për çdo student, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë.</p>




	<p>Sekretaria Mësimore e programit të studimit, Kryesekretaria e Fakultetit, dhe Administratori i Përgjithshëm menaxhojnë dhe administrojnë të gjithë informacionin e studentëve gjatë viteve. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga regjistrimi i tyre deri në diplomim, ruhen në bazën e të dhënave të sekretarisë mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe ruan në dosje dokumentacionin për çdo student të regjistruar, i çregjistruar, si dhe për studentët që kanë përfunduar studimet.</p> <p><i>Evidencë nr. tabela 23</i></p>			
Konkluzion	<p><i>“Albanian University” ka përcaktuar qartë procedurat për përfundimin e studimeve, mbrojtjen e diplomës dhe provimin e formimit. Studentët pajisen me diplomë sipas standardeve të miratuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin përkatës.</i></p> <p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes (DEA) ka hartuar një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, e cila bëhet publike për të siguruar transparencë dhe realizim të tyre në mënyrë korrekte.</i></p> <p><i>Studentët mbështeten nga stafi akademik dhe Sekretaria Mësimore me informacion, udhëzime dhe materiale të nevojshme. Detyrimet përmbyllëse përfshijnë provimin përfundimtar ose shkrimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës, sipas rregullores së miratuar.</i></p> <p><i>Në përfundim të programit të studimit, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e cila përmban elementet përbërëse, formën dhe procedurat për regjistrim, të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin.</i></p> <p><i>Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Humanitare (FSHSH) ruan dokumentacionin e studentëve dhe lëshon dokumente sipas kërkesës së tyre dhe në përputhje me rregullat në fuqi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), dokumentacionit të dorëzuar në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), si dhe takimeve të zhvilluara me stafin akademik të përfshirë në procesin e mësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Anglisht” i përmbahet kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përkatësisht në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse.

Personeli akademik me kohë të plotë plotëson kriteret për kualifikimin shkencor dhe përvojën akademike dhe pedagogjike, sipas parashikimeve ligjore dhe siç vërtetohet në dokumentacionin e paraqitur, përfshirë CV-të individuale. Ngarkesa mësimore e këtij personeli është e përshtatur dhe në përputhje me fushat e tyre të specializimit.

Niveli i kualifikimit, si dhe fushat akademike dhe kërkimore të personelit, janë të harmonizuara me objektivat, kërkesat dhe specifikimet e programit të studimit Bachelor në “Anglisht”.

Angazhimi i stafit akademik i Departamentit në vite është si më poshtë:

Viti akademik 2020–2021: 11 pedagogë me angazhim të plotë (PAE) dhe 15 pedagogë me angazhim të kufizuar (PAK);

Viti akademik 2021–2022: 11 PAE dhe 18 PAK;

Viti akademik 2022–2023: 11 PAE dhe 18 PAK;

Viti akademik 2023–2024: 13 PAE dhe 18 PAK;

Viti akademik 2024–2025: 12 PAE dhe 16 PAK.

Nga tabela e paraqitur, për vitin akademik 2024 -2025 për Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes rezultojnë sa më poshtë:

Stafi me kohë të plotë (total 12):

- 1 Profesor Doktor (Prof. Dr)

- 5 Profesorë të Asociuar Doktorë (Prof. Asoc. Dr)

- 6 Doktorë shkencash (Dr)

Stafi me kohë të pjesshme (gjithsej 16):

- 2 Profesorë Doktorë (Prof. Dr)

- 5 Profesorë të Asociuar Doktorë (Prof. Asoc. Dr)

- 4 Doktorë shkencash (Dr)

- 5 Master Shkencorë (Msc)

Të dhënat tregojnë një angazhim të qëndrueshëm të personelit akademik, i cili garanton mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe përmbushjen e standardeve akademike të programit të studimit.

Per programin Bachelor në “Anglisht” për vitin akademik 2024-2025, ku zhvillohet mësim vetëm në vitin e parë janë angazhuar pesë pedagogë efektiv (PAE), - 1 Profesor Doktor .



	<p>- 1 Profesorë të Asociuar Doktorë (Prof. Asoc. Dr) dhe tre Doktorë shkencash (Dr) dhe pedagog i jashrem 1 Profesor Doktorë (Prof. Dr</p> <p><i>Evidenca Tabelat 1.1. 2.3.4.5.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në programin Bachelor në “Anglisht”, personeli akademik efektiv ka një rol të rëndësishëm jo vetëm për nga sasia e orëve të mësimi që mbulon, por edhe për nga lëndët shkencore që zhvillon. Analiza e ngarkesës mësimore tregon se pjesa më e madhe e saj mbahet nga Personeli Akademik Efektiv (PAE). Për lëndët kryesore të këtij programi, angazhohet staf akademik me përvojë dhe kualifikime të përshtatshme.</p> <p>Formimi akademik dhe kërkimor i pedagogëve që kontribuojnë në mësimdhënie në programin Bachelor në “Anglisht” përputhet plotësisht me përmbajtjen e moduleve dhe lëndëve që ata zhvillojnë. Bazuar në të dhënat e vitit akademik, personeli akademik efektiv mbulon më shumë se 70% të ngarkesës mësimore në këtë program. Për vitin akademik 2023–2024, rreth 59.65% e ngarkesës mësimore është realizuar nga personeli i brendshëm (PAE), ndërsa 40.35% nga personeli i jashtëm (PAK), duke treguar një përfshirje të konsiderueshme të stafit të brendshëm në zhvillimin e programit. Ndërsa për vitin akademik 2024–2025, në vitin e parë të këtij viti, rreth 80.8% e ngarkesës mësimore realizohet nga personeli i brendshëm (PAE), dhe vetëm 19.2% nga personeli i jashtëm (PAK).</p> <p><i>Evidencë nr. Tabela 12.1,2,3,4 (Ngarkesat mësimore të pedagogëve për programin Bachelor në “Anglisht” për vitet 2022-2025</i> <i>Evidencë nr.IV.1 - Vendim SA për ngarkesat (1).pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në përputhje me udhëzimet që ofron Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, institucioni dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në përputhje me Udhëzimin Nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, Senati Akademik i Albanian University ka vendosur që ngarkesa mësimore vjetore për “Albanian University” toritetet drejtuese dhe personelin akademik të përshtatet me nevojat e njëjësive bazë, kohëzgjatjen e kontratës, pagesën e stafit akademik, si dhe detyrimet ligjore lidhur me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Evidencë IV.2.a-Kontrata PAE.pdf</i> <i>Evidencë nr.IV.2.b-Kontrata PAK.pdf</i></p>




	<i>Evidencë nr.IV.2.c-Kontrata PA.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ku konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe për personelin ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Universiteti ka përcaktuar kriteret e përgjithshme që kandidatët konkuroes duhet të përmbushin, të cilat përfshijnë: a. Diplomimin përkatës dhe përputhshmërinë e formimit me vendin e punës të kërkuar, b. Formimin e përgjithshëm arsimor dhe profesional, c. Kualifikimet akademike (gradat shkencore ose titujt akademikë) dhe rezultatet e kërkimit shkencor, brenda dhe jashtë vendit, d. Përvojën pedagogjike dhe eksperiencën e mëparshme universitare, e. Zotërimin e aftësive personale të nevojshme për pozicionin e punës. Pas shqyrtimit të kandidaturave, Komisioni i Vlerësimit propozon Dekanin kandidatët e përzgjedhur, të renditur sipas përshtatshmërisë me kriteret e kërkuara dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. <i>Evidencë nr.IV.3 - Procedura e rekrutimit të stafit akademik.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve specifike të programit të studimit Bachelor në “Anglisht” dhe angazhon personel ndihmës akademik të përshtatshëm realizimin për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes disponon aktualisht tre laboratorë: Laboratori i Artit Figurativ, i cili ofron mbështetje për studentët në realizimin e punimeve në lëndën e artit figurativ. Laboratori i Aplikimeve Kompjuterike, ku është i angazhuar një staf ndihmës akademik; në këtë laborator zhvillohen lëndët e Fonetikës dhe Anglishtes së medias, nën drejtimin e pedagogut përkatës. Laboratori i Muzikës, ku studentët zhvillojnë lëndën e muzikës. <i>Evidencë nr.IV.4 Planimetritë e godines FSHSH.pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rmbrojtjen e të dhënavepersonale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë	Të gjitha të dhënat që lidhen me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe përditësohen periodikisht (të paktën një herë në vit) në arkivën e Departamentit përkatës, si dhe në atë të Zyrës së Burimeve Njerëzore. Institucioni administron dhe ruan në mënyrë të strukturuar informacionin lidhur me personelin akademik dhe personelin ndihmës mësimor-shkencor, përfshirë ngarkesën mësimore përkatëse për çdo semestër të vitit akademik. Stafi akademik i programit eshte




<p>në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semester dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>2024-2025 : 5 PAE/I PAK 2023-2024 : 4 PAE/ 1PAK 2022-2023 : 5 PAE/ 4 PAK</p>
<p>Kriteri 7.Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike si pas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimet e “Albanian University” me industrinë, biznesin dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të formalizuara dhe të institucionalizuara. Në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, universiteti ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi si brenda institucionit, ashtu edhe me institucione, kompani dhe palë të treta, me qëllim garantimin e realizimit të suksesshëm të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”.</p> <p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në zbatim të objektivave të këtij programi studimi, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore Rajonale për zhvillimin e praktikës profesionale, e cila përbën një komponent thelbësor të kurrikulës.</p> <p>Praktikat mësimore organizohen në përputhje me afatet e përcaktuara në kalendarin akademik dhe zhvillohen në institucionet me të cilat universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Çdo praktikë monitorohet nga një pedagog i caktuar nga Departamenti përkatës, i cili, në përputhje me VKM nr. 418, datë 10.05.2017, mbikëqyr jo më shumë se 20 studentë.</p> <p>Në kuadër të këtyre marrëveshjeve, institucionet pritëse angazhohen të caktojnë një udhëheqës të praktikës, përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e vijueshmërisë dhe cilësisë së praktikës mësimore.</p> <p>Gjatë periudhës së praktikës, studentët udhëhiqen dhe mbikëqyren nga pedagogu i ngarkuar për ndjekjen e saj. Staf i akademik që mbulon këtë komponent është pjesë integrale e marrëveshjeve të bashkëpunimit, të hartuara posaçërisht për zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p>Në përfundim të praktikës, pedagogu mentor shpërmdan për secilin student formularin e vlerësimit të praktikës. Ky formular plotësohet nga mentori i institucionit pritës, firmoset prej tij dhe vulloset nga drejtuesi i institucionit. Më pas, studenti dorëzon formularin së bashku me dosjen përkatëse të pedagogu përgjegjës për praktikën mësimore.</p> <p><i>Evidencë nr. R.I- Rregullore e Programit të Studimit Bsc. Anglisht.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.VII.d Marrëveshja me ZVA Tiranë 2021.pdf</i> <i>Evidencë R.VII.d.1. ZVA.Tiranë 2020.pdf</i> <i>Evidence R.VII.d.2. Marrëveshja me ZVA Lushnje.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.VII.d Marrëveshja ZVA Lushnje 2023.pdf</i> <i>Evidence R.VII.d.3. Marrëveshja me ZVA Kruje</i> <i>Evidencë nr.I.8. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf</i></p>
<p>Kriter 8.Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që</p>	<p>“Albanian University” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore për zhvillimin e praktikave mësimore. Udhëheqësi</p>




<p>angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>i praktikës, i angazhuar nga institucioni pritës për mbështetjen e studentit praktikant, luan një rol thelbësor në realizimin e suksesshëm të lëndës së Praktikës Profesionale. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij përfshijnë:</p> <p>Udhëheqjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të studentit gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës;</p> <p>Njohjen e studentit me dokumentacionin përkatës që duhet të plotësohet gjatë praktikës;</p> <p>Përfshirjen aktive të studentit në procesin mësimor/praktik, në përputhje me objektivat e lëndës;</p> <p>Vlerësimin e performancës së studentit përmes plotësimit të formularit të vlerësimit të praktikës.</p> <p>Studenti ndihmohet të plotësojë dosjen sipas nje modeli të dhene, i cili përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që studentët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në përfundim të praktikës.</p> <p><i>Evidencë nr. R.VII.d Marrëveshja me ZVA Tiranë 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë R.VII.d.1. ZVA.Tiranë 2020.pdf</i></p> <p><i>Evidence R.VII.d.2. Marrëveshja me ZVA Lushnje.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. RVII.d Marrëveshja ZVA Lushnje 2023.pdf</i></p> <p><i>Evidence R.VII.d.3. Marrëveshja me ZVA Kruje</i></p>
--	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Anglisht" mbulohet nga staf akademik i kualifikuar dhe me përgatitje të specializuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja dhe angazhimi i personelit zhvillohet nëpërmjet një procedure transparente dhe të standardizuar, e cila garanton përzgjedhjen e kandidatëve që plotësojnë kriteret e nevojshme për nivelin dhe natyrën e pozicionit të punës. Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv, duke reflektuar kështu një strukturë të konsoliduar dhe të vazhdueshme në funksionimin e programit.</i></p> <p><i>Ndarja e ngarkesës mësimore bëhet mbi bazën e ekspertizës dhe përvojës akademike të pedagogëve, duke siguruar shpërndarje të balancuar dhe në përputhje me profilin e secilit anëtar të stafit. Në kuadër të këtij programi janë të angazhuar lektorë me kohë të plotë dhe personel akademik me kohë të pjesshme, të cilët janë të punësuar me kontrata formale pune.</i></p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimet në terren, rezulton se personeli akademik është i qëndrueshëm dhe kontribuon në mënyrë aktive në realizimin e objektivave të programit të studimit.</i></p> <p><i>Rekrutimi i stafit të ri zhvillohet mbi bazën e kriterëve të shpallura publikisht dhe procedura e përzgjedhjes realizohet nëpërmjet konkursit të hapur, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret institucionale.</i></p> <p><i>Zyra e Burimeve Njerëzore administron listat e plota të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ për çdo semestër. Këto të dhëna përditësohen rregullisht dhe pasurohen çdo vit akademik, duke respektuar kërkesat e akteve rregullatore në fuqi.</i></p> <p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes (DEA) ka caktuar një numër të mjaftueshëm pedagogësh të kualifikuar për mbikëqyrjen dhe</i></p>
---------------------------	---




	<i>udhëheqjen e praktikave profesionale. Pedagogu i ngarkuar për praktikën siguron bashkëpunimin me institucionin pritës (shkollën), vëzhgon dhe udhëzon studentin gjatë procesit të praktikës, si dhe jep vlerësimin përfundimtar mbi realizimin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes zhvillon aktivitetin e tij në godinën qendrore, e cila ndodhet në Bulevardin “Zogu I”. Për mbështetjen e programeve të studimit Bachelor dhe Master Profesional që ai ofron, është vënë në dispozicion një ndërtesë e madhe dhe plotësisht e rikonstruktuar. Kjo ndërtesë është përshtatur posaçërisht për nevojat e institucionit dhe përfshin salla leksionesh, seminaresh si dhe laboratorë të pajisur për zhvillimin efektiv të lëndëve dhe moduleve të ndryshme.</p> <p>Hapësirat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor në “Albanian University”. Ato përmbushin kërkesat për numrin e studentëve dhe grupeve mësimore, si dhe janë në përputhje me karakteristikat e veçanta të lëndëve të ofruara në programin e studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ inspektoi ambientet ku zhvillohet mësimi për programin Bachelor në “Anglisht” dhe konstatoi se godina e Fakultetit të Shkencave Shoqërore është funksionale dhe e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Evidencë nr. IV.4 Planimetritë e godines FSHSH</i></p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme fizike dhe me pajisje bashkëkohore teknologjike, përfshirë kompjuterë, videoprojektorë dhe mjete të tjera ndihmëse, të cilat mundësojnë zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Gjithashtu, e gjithë godina mbulohet nga një rrjet interneti Wireless, i cili është i aksesueshëm për të gjithë përdoruesit e institucionit.

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	
<p>Kriteri 3.Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për të mbështetur programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, janë ngritur dhe vihen në përdorim tre laboratorë të specializuar:</p> <p>1. Laboratori i Edukimit Figurativ Ky laborator është i pajisur me të gjitha materialet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e punëve praktike nga studentët. Gjatë orëve të praktikës, studentët punojnë në mënyrë të pavarur, nën mbikëqyrjen e pedagogut, duke zhvilluar aftësitë e tyre në përputhje me objektivat mësimorë të lëndës.</p> <p>2. Laboratori i Informatikës / English New Media Centre Ky laborator është krijuar për të mbështetur programin Bachelor në “Anglisht” dhe është konceptuar mbi modelet bashkëkohore të qendrave të mediave në gjuhën angleze (English Neë Media Centres) të universiteteve ndërkombëtare. Ai përbëhet nga njëzet e pesë kompjuterë të pajisur me kufje, të cilët lejojnë realizimin e punëve individuale dhe në grup, të drejtuara nga kompjuteri qëndror. Në këtë laborator janë të instaluar programe specifike që mbështesin zhvillimin e lëndëve si Fonetikë dhe Anglishtja e Medias, duke ndihmuar studentët në përvetësimin praktik të njohurive gjuhësore dhe teknologjike.</p> <p>3. Laboratori i Edukimit Muzikor Ky laborator është i pajisur me vegla muzikore të nevojshme për zhvillimin e orëve praktike në lëndët e Edukimit Muzikor dhe Didaktikës së Edukimit Muzikor.</p>
<p>Kriteri 4.Institucioni I arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë së informacionit, duke e pajisur atë me programe profesionale që mbështesin procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Anglisht”, është ngritur Laboratori i Informatikës, i konceptuar sipas modeleve bashkëkohore të njohura si English Neë Media Centre, të përdorura në universitete ndërkombëtare. Ky laborator përbëhet nga njëzet e pesë kompjuterë të pajisur me kufje, të cilët u mundësojnë studentëve të zhvillojnë punë individuale dhe bashkëpunuese, të organizuara dhe të drejtuara nga kompjuteri qëndror. Në këtë ambient janë instaluar programe të specializuara që përdoren në lëndë si Fonetikë dhe Anglishtja e Medias, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve në gjuhën angleze. Ndërtimi dhe funksionalizimi i këtij laborator është mbështetur nga Profesor David Adamson, pedagog në Universitetin e Strasburgut dhe drejtues i Qendrës së Gjuhëve dhe Laboratorëve pranë këtij universiteti. Profesor Adamson, së bashku me kolegë të tjerë, ka shprehur gatishmërinë për të kontribuar në këtë projekt përmes leksioneve të drejtpërdrejta, videokonferencave dhe bashkëbisedimeve</p>




	<p>me studentët, si dhe përmes zhvillimit të programeve metodike që do të përdoren në laborator.</p> <p>Gjithashtu, salla e bibliotekës e ndodhur në të njëjtën godinë është e pajisur me kompjuterë të cilët janë në dispozicion të studentëve për kërkime, studime dhe përdorim akademik.</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ofron mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit akademik, duke mbështetur si përvetësimin teorik, ashtu edhe formimin praktik të studentëve në përputhje me natyrën e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes disponon hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatura për zhvillimin e mësimdhënies teorike në "Albanian University" ditorë, të cilët përpunohen me numrin e studentëve dhe karakteristikat e lëndëve të përfshira në programin e studimit. Një pjesë e këtyre ambienteve janë të pajisura me mjete moderne elektronike, si projektorë, laptopë dhe lidhje të qëndrueshme në internet, të cilat mbështesin zhvillimin efektiv të procesit mësimor. Në përputhje me fushën e studimeve që mbulon dhe natyrën e programit, Departamenti ka në funksion të plotë tre laboratorë të specializuar, të cilët shërbejnë për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, veçanërisht në të dëgjuar dhe të folur. Këto laboratorë janë të pajisur me teknologji moderne dhe programe të dedikuara, duke krijuar një mjedis optimal për mësim të integruar teorik dhe praktik. Gjithashtu, institucioni ka siguruar një infrastrukturë të konsoliduar të teknologjisë së informacionit, të pajisur me softuerë profesionale që mbështesin si procesin mësimor, ashtu edhe aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit dhe studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sës tandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Departamenti i Edukimit dhe i Gjuhës Angleze vë në dispozicion të studentëve literaturë në gjuhën angleze në formatin digjital, të përfshirë në syllabuset e lëndëve, që garanton përvetësimin e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu, literatura bazë dhe ndihmëse në gjuhën shqipe, në përputhje me syllabuset e lëndëve, vihet në dispozicion të studentëve pranë bibliotekës në format fizik (hardcopy). Kjo literaturë garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme sipas programit të studimit përkatës.</p>




	<p>GVJ konstaton se kopjet fizike të librave në gjuhën angleze nuk janë të mjaftueshme për lëndët e këtij programi. Gjatë vëzhgimit në bibliotekë, nuk u gjetën librat e përfshirë në shkresën e blerjeve të datës 29.10.2024. Kopjet fizike të librave në anglisht, të pranishme në bibliotekë, nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e objektivave të programi.</p> <p><i>Evidencë nr.II.10 - Lista e teksteve ne biblioteke.pdf</i> <i>Evidencë R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2.Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, në përputhje me rishikimet e syllabuseve, Departamenti i Edukimit dhe i Gjuhës Angleze harton dhe paraqet kërkesat për shtimin e literaturës në bibliotekë, si në aspektin e titujve ashtu edhe të numrit të kopjeve. Në funksion të mbështetjes së programeve të studimit që ofron DEA, janë dhuruar gjithashtu një numër i konsiderueshëm titujsh të literaturës nga vetë lektorët e departamentit.</p> <p><i>R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.II.b - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i> <i>Evidencë nr.R.II.c - Dhurimi i librave V.Tafani.pdf</i> <i>Evidencë R.II.d. Dhurimi i librave nga Akademia e Shkencave te Shqiperise.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3.Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Albanian University dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore kanë vënë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit Bachelor dhe Master Profesional, të ofruara nga Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes (DEA), një ambient të përshtatshëm për bibliotekën mësimore. Ambienti i dedikuar i bibliotekës ofron hapësira të mjaftueshme për lexim dhe studim individual apo në grup nga ana e studentëve. Në këtë hapësirë janë instaluar kompjuterë, të cilët vihen në dispozicion të studentëve për: kërkime të informacionit online, akses në literaturë elektronike, shfrytëzim të materialeve digjitale pranë kompjuterëve të sallës së leximit, si dhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit të nevojshëm për studime dhe kërkime akademike.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e “Albanian University” ofron një gamë të gjerë literature me qasje multidisiplinare për studentët.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore vë në dispozicion të studentëve rreth 1800 tituj librash në fushën e mësuesisë. Mbi 80% e literaturës së detyrueshme në gjuhën shqipe, e përcaktuar në syllabuset e lëndëve, gjendet aktualisht në fondin e bibliotekës.</p> <p>Literatura e ofruar, si në format fizik, ashtu edhe në formë elektronike dhe online, u mundëson studentëve realizimin me sukses të detyrave kërkimore-shkencore të parashikuara nga pedagogët, si pjesë e procesit mësimor dhe përgatitjes së tezës së diplomës.</p> <p><i>Evidencë nr.IV.6 - Bibliotekat online</i></p>




<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka ndërmarrë hapa për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online që lidhen me fushën e programit të studimit Studentëve u vihet në dispozicion një sërë librarish online, të cilat janë të aksesueshme në qendrën e internetit, nën mbikëqyrjen dhe asistencën e punonjësës së bibliotekës. Këto libra online, të këshilluara për përdorim akademik, janë kryesisht në gjuhë të huaj dhe përfshijnë burime të vlefshme për kërkime dhe studime të thelluara.</p> <p>Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Albanian University dhe Albanian College Tirana, studentët kanë gjithashtu akses në bibliotekat e ACT, duke zgjeruar më tej mundësitë për qasje në literaturë dhe burime shkencore cilësore.</p> <p>Gjithashtu sipas faqes online të Institucionit ka lidhje online me biblioteka ndërkombëtare. Katalogu elektronik për përdorim në bibliotekë është i sistemuar dhe i klasifikuar sipas departamenteve.</p> <p>Në portalin eëë.portal.getty.edu ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë botën nga të cilat 6.400 janë vetëm mbi arkitekturën. Ndërsa në bibliotekën online eëë.elsevier.com ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta.</p> <p><i>Evidencë nr.IV.5 -Marrëveshja me ACT</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka-online/</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në ambientet e bibliotekës janë instaluar kompjuterë, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke u mundësuar atyre akses në internet si dhe shfrytëzimin e librarive online të rekomanduara nga departamenti. Kjo infrastrukturë teknologjike mbështet procesin e të nxënies, kërkimin shkencor dhe përgatitjen akademike të studentëve.</p> <p><i>(Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi të përshtatura me zhvillimin e procesit mësimor, duke u përgjigjur në mënyrë efektive nevojave dhe numrit të studentëve që e frekuentojnë. Kapacitetet fizike dhe funksionale të bibliotekës janë të përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të përdoruesve të saj.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë nga e mërkura në të premte, ora 08:00 – 16:00, dhe ditën e shtunë, ora 08:00 – 12:00. Këto orare janë të shpallura në ambientet e fakultetit dhe janë të njohura për studentët.</p> <p>Për studentët e programeve të studimit Master, biblioteka ofron akses edhe gjatë orareve të pasdites (16:00 – 20:00), përmes bashkëpunimit me sekretarinë mësimore, e cila mbështet shërbimin ndaj këtyre programeve në përputhje me oraret e tyre mësimore.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe</p>	<p>Sipas RVB, biblioteka, në bashkëpunim me fakultetet përkatëse, dorëzon pranë Administratorit kërkesat për blerje literaturës shkencore. Për çdo vit akademik parashikohen fonde specifike për blerjen e librave, në funksion të mbështetjes së programeve të studimit. Departamenti i Edukimit dhe i</p>




<p>fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Anglishtes mban një komunikim të vazhdueshëm me punonjësen e bibliotekës së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, me qëllim monitorimin e përdorimit të fondit të literaturës nga studentët dhe stafi akademik, identifikimin e nevojave për përditësim dhe pasurim të mëtejshëm të fondit të bibliotekës.</p> <p>Në mbështetje të programit të studimit Bachelor në "Anglisht", janë vënë gjithashtu në dispozicion biblioteka online, që plotësojnë nevojat për literaturë në gjuhë të huaj.</p> <p>Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), bazuar në përcaktimet e RVB-së dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, konstaton se pasurimi i bibliotekës nuk kryhet në mënyrë periodike, por është i kushtëzuar nga mundësitë buxhetore të institucionit dhe realizohet përmes: blerjeve të reja, dhe dhurimeve nga stafi akademik ose partnerë të jashtëm.</p> <p><i>Evidencë nr.IV.6 - Bibliotekat online</i> <i>Evidencë R.II.a - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i> <i>Evidencë nr. R.II.b - Procedura e blerjeve të teksteve.pdf</i> <i>Evidencë nr.R.II.c - Dhurimi i librave V.Tafani.pdf</i> <i>Evidencë R.II.d. Dhurimi i librave nga Akademia e Shkencave te Shqiperise.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes vë në dispozicion të studentëve literaturë në gjuhën angleze në format digjital, e cila është e përfshirë në syllabuset e lëndëve dhe mbështet përbushjen e objektivave të programit të studimit.</i></p> <p><i>Shërbimi bibliotekar ofrohet në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe personelin akademik, përfshirë edhe ditët e fundjavës, duke garantuar akses të vazhdueshëm në burimet studimore.</i></p> <p><i>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Shoqërore pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me literaturë të detyrueshme dhe të rekomanduar, në përputhje me kërkesat e departamenteve përkatëse. Këto kërkesa burojnë nga bashkëpunimi i drejtpërdrejtë ndërmjet strukturave akademike dhe bibliotekës, me synimin për të përbushur nevojat në rritje të studentëve dhe stafit akademik.</i></p> <p><i>Ambienti i dedikuar për bibliotekën ofron hapësira të përshtatshme për lexim dhe studim, si individual ashtu edhe në grup. Në këtë ambient janë instaluar kompjuterë të cilët vihen në dispozicion të studentëve, të pajisur me programe mbështetëse në përputhje me kërkesat e programit të studimit.</i></p> <p><i>Megjithatë, GVJ konstaton se pasurimi i fondit të bibliotekës fizike nuk është kryer në mënyrë periodike, dhe se në vitet e fundit nuk janë kryer blerje librash. Për këtë arsye, GVJ sugjeron që "Albanian University" t'i kushtojë vëmendje të veçantë alokimit të buxhetit për pasurimin e fondit të bibliotekës, duke garantuar fonde të dedikuara për blerjen e literaturës dhe titujve të nevojshëm, sidomos në mbështetje të programit të studimit në "Anglisht".</i></p>




Shkalla e përmbushjessëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesish	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon system të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi dhe menaxhimi i të dhënave të studentëve ndër vite realizohet nga sekretaria mësimore e programit të studimit, në bashkëpunim me kryesekretaren e fakultetit dhe Administratorin e Përgjithshëm të institucionit. Këto struktura janë përgjegjëse për ruajtjen, përditësimin dhe administrimin e të gjithë informacionit të studentëve, që nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e studimeve dhe diplomim.</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu statistika vjetore që përfshijnë: numrin e studentëve të regjistruar në programet e ciklit të parë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë; numrin e tërheqjeve nga programet; largimet para përfundimit të studimeve; rastet e mospërfundimit me sukses të vitit akademik; të dhëna për ecurinë akademike të studentëve nga pranimi deri në diplomim.</p> <p>Të dhënat ruhen në format fizik dhe elektronik, dhe janë të dokumentuara në: Regjistrin Themeltar , Regjistrin e Indeksit , Regjistrin e Rezultateve Akademike, Regjistrin e Diplomave.</p> <p>Të dhënat statistikore i raportohen periodikisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Rektoratit të institucionit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative.</p> <p>“Albanian University” përdor gjithashtu platformën Pitagora (http://Albanian University.pitagora.rash.al), të mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), si sekretari elektronike. Çdo student zotëron llogarinë personale, përmes së cilës mund të identifikohet me kredencialet përkatëse dhe të ketë akses në:</p> <ul style="list-style-type: none"> -të dhënat e përditësuara personale dhe akademike, -rezultatet e arritura, -informacionin mbi lëndët që duhet të ndjekë dhe të frekuentojë, - si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për ecurinë e tij akademike.
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit</p>	<p>Bazuar në Statutin e “Albanian University” si dhe dosjet e personelit nga vizita e GVJ në institucion, dokumentacioni lidhur me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, nga momenti i tyre i rekrutimit e deri në vazhdimësinë e angazhimeve, menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore</p>




<p>ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të të dhënave funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përcaktuara për secilin përdorues, në përputhje me pozicionin dhe funksionin që ata mbajnë në institucion. Përdoruesit “Albanian University” identifikohen në sistem përmes adresës zyrtare të email-it dhe fjalëkalimit personal, duke pasur akses vetëm në të dhënat që lidhen me rolin e tyre në institucion.</p> <p>Ky sistem mundëson administrimin efektiv të të dhënave të studentëve dhe u ofron atyre një hapësirë të dedikuar personale, nga e cila mund të: konsultojnë rezultatet e provimeve, regjistrojnë modulet dhe provimet e përsëritura, ndjekin progresin akademik, etj. Në këtë mënyrë, sigurohet privatësia e të dhënave personale, konfidencialiteti dhe respektimi i lirisë akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Të gjitha të dhënat janë të ruajtura në mënyrë të sigurt dhe të aksesueshme për të gjithë vitet në të cilat përdoruesi është pjesë e institucionit. Qasja në informacion është e kufizuar vetëm brenda aktiviteteve dhe përgjegjësive të secilit përdorues, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave për çdo student apo anëtar të personelit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore.</p>
<p>Kriteri 4.Sistemi I menaxhimit ka të integruar platform dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve zhvillohet në mënyrë interaktive dhe të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik, përmes platformës Microsoft Teams, e cila është vënë në dispozicion nga institucioni si mjet zyrtar për komunikim dhe bashkëpunim akademik.</p> <p>Përveç platformës digjitale, komunikimi dhe koordinimi mes palëve realizohet edhe fizikisht, në ambientet e institucionit, përmes adresave zyrtare të emailit institucional, të cilat janë të aksesueshme dhe të përdorura rregullisht nga të dyja palët.</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson pozitivisht përdorimin e formave të ndryshme të komunikimit interaktiv, përfshirë rrjetet sociale dhe komunikimin përmes email-it, të cilat kontribuojnë në një komunikim të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas me studentët, duke forcuar mbështetjen institucionale ndaj tyre.</p>
<p>Kriteri 5.Sistemi I menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative dhe mundëson</p>	<p>Sistemi elektronik i menaxhimit në “Albanian University” garanton monitorim në kohë reale të aktiviteteve akademike dhe administrative, duke mundësuar raportime të personalizuar sipas roleve që përdoruesit mbajnë në institucion.</p>




<p>raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe "Albanian University" toritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi është i automatizuar dhe gjeneron në mënyrë të rregullt raportime që lidhen me: kalueshmërinë e studentëve, notën mesatare për lëndë dhe për vit akademik, përdorimin dhe menaxhimin e ambienteve didaktike, dhe të dhëna të tjera statistikore që ndihmojnë në vendimmarrjen institucionale.</p> <p>Të gjitha aktivitetet akademike dhe administrative, përfshirë oraret, njoftimet, vendimet dhe informacione të tjera relevante, janë të publikuara në faqen zyrtare të "Albanian University" (www.albanianuniversity.edu.al) dhe janë të aksesueshme nga të gjithë përdoruesit, në përputhje me rolet dhe njësitë përkatëse të strukturës institucionale.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dygjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të gjitha informacionet që lidhen me Departamentin e Edukimit dhe të Anglishtes, si dhe me programet e studimit që ky departament ofron, janë të publikuara në faqen zyrtare të "Albanian University" (www.albanianuniversity.edu.al).</p> <p>Po në këtë faqe, përdoruesit mund të aksesojnë të dhëna të detajuara mbi stafin akademik të departamentit, përfshirë përshkrimin e profileve profesionale, ngarkesën akademike dhe fushat e ekspertizës.</p> <p>Aktivitetet e planifikuara dhe të zhvilluara nga departamenti dhe institucionet mbështetëse publikohen rregullisht si në faqen zyrtare të universitetit, ashtu edhe në rrjetet sociale zyrtare të institucionit, duke rritur transparencën dhe komunikimin me publikun e gjerë.</p> <p>Faqja zyrtare e universitetit ofron informacion në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke garantuar akses të gjerë dhe gjithëpërfshirës për studentët vendas dhe të huaj, stafin akademik, partnerët institucionalë dhe aktorët e tjerë të interesuar.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-staf/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Albanian University disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, i cili shërben për administrimin, informimin dhe monitorimin e të gjithë aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ të zhvilluar në kuadër të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Në funksion të administrimit efektiv të informacionit për studentët, "Albanian University" përdor sistemin elektronik Pitagora, i cili mundëson:</i></p> <p><i>regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave studentore, menaxhimin e notave dhe progresit akademik, aksesin individual të studentëve në të dhënat personale dhe akademike.</i></p> <p><i>Sistemi i menaxhimit ofron akses në dokumente dhe informacione të dedikuara për të gjithë personelin dhe studentët, në përputhje me rolin dhe funksionin e tyre në institucion.</i></p> <p><i>"Albanian University" ka zbatuar sisteme të integruara informacioni, ku përveç Pitagora, përdoret edhe platforma Microsoft Teams për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë dhe interaktiv midis stafit</i></p>




	<p><i>akademik dhe studentëve, në funksion të procesit mësimor dhe koordinimit institucional.</i></p> <p><i>Sistemi elektronik i menaxhimit garanton gjithashtu monitorimin në kohë reale të informacionit që lidhet me procesin mësimor dhe zbatimin e programit nga ana e stafit akademik, duke kontribuar në ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë akademike.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, veprimtaritë akademike dhe studentore, publikohen në mënyrë të rregullt në faqen zyrtare të universitetit (www.albanianuniversity.edu.al), në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë palët e interesuara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1.Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dorëzuar, konstatohet se “Albanian University”, si pjesë e Shoqërisë “UFO” sh.p.k., përfiton një buxhet vjetor të planifikuar në përputhje me nevojat institucionale, mbi bazën e një programi financiar afatmesëm trevjeçar. Ky program përfshin gjithashtu planin për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e programeve të studimit.</p> <p>Hartimi i buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm trevjeçar realizohet në përputhje me Standardet Kombëtare të Hartimit dhe Raportimit Financiar; Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe Aktet nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve si dhe Aktet normative të brendshme të “Albanian University”.</p> <p>Procesi i hartimit të programit financiar fillon në muajin shtator dhe përfundon me miratimin nga organet përkatëse brenda muajit dhjetor të vitit pararendës financiar. Përpara fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit përcakton kriteret themelore mbi të cilat do të mbështetet projektbuxheti vjetor, si dhe rregullat për mënyrën e administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave të gjeneruara nga aktivitetet e institucionit. Këto udhëzime i përcillen strukturave akademike dhe administrative për zbatim të mëtejshëm.</p> <p>Bazuar në këto kritere, Administratori i Përgjithshëm i “Albanian University”, i cili është gjithashtu anëtar i Rektoratit, në bashkëpunim</p>




	<p>me Zyrën e Financës dhe administratorët e njësive kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe programin financiar afatmesëm trevjeçar. Ky proces mbështetet në analizën e nevojave të paraqitura nga njësitë bazë dhe ato kryesore të institucionit, duke siguruar koherencë me objektivat strategjike dhe zhvillimore të universitetit.</p> <p>Pas shqyrtimit në Rektorat, projektbuxheti vjetor dhe ai afatmesëm trevjeçar i “Albanian University” i paraqitet Senatit Akademik, i cili realizon miratimin paraprak të tij. Pas këtij hapi, dokumenti financiar i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit, në përputhje me strukturën vendimmarrëse të institucionit dhe kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>Evidencë nr.IV.8 - Buxheti DEA</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të</p>	<p>Programi financiar i “Albanian University” strukturohet duke klasifikuar të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas fushave përkatëse të përdorimit. Burimet financiare planifikohen duke u bazuar në nevojat për zhvillimin normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarive mësimore dhe kërkimore të institucionit, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e tyre. Pjesa më e madhe e shpenzimeve lidhet me veprimtarinë mësimore dhe përfshin pagat dhe kontributet shoqëruese për personelin akademik dhe administrativ, fondet për kërkimin shkencor, shpenzimet operative të përgjithshme si dhe fondet për investime strategjike.</p> <p>Zërat buxhetorë hartohen në bazë të nevojave të paraqitura nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore të institucionit, në përputhje me planin e investimeve dhe objektivat zhvillimore. Zbatimi i buxhetit mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar efikasitet dhe përputhje me qëllimet e përcaktuara.</p> <p>Në këtë kuadër, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, në fillim të çdo viti akademik, harton buxhetin e vet specifik, i cili integrohet si pjesë përbërëse e buxhetit vjetor të “Albanian University”. Ky buxhet përmban një pasqyrë të qartë të aktiviteteve të planifikuara si dhe fondet e nevojshme për realizimin e tyre.</p> <p>Aktivitete si konferencat shkencore apo ato studentore, të organizuara nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, janë mbështetur financiarisht nga universiteti, duke reflektuar përkushtimin e tij për promovimin e kërkimit shkencor dhe angazhimit akademik të studentëve dhe stafit.</p> <p><i>Evidencë nr.IV.9 - Shkresë për konferencat</i></p>




<p>Kriteri 3.Institucioni kryen “Albanian University”ditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në kuadër të strukturës së brendshme administrative të “Albanian University”, është ngritur dhe funksionon Zyra e auditit të Brendshëm, si njësi e specializuar në kuadër të sistemit të kontrollit të brendshëm institucional. Kjo zyrë ka për mision të monitorojë zbatimin e procedurave dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Zyrës së Financës dhe të Auauditit të Brendshëm, duke garantuar përputhshmëri me praktikat e mirëadministrimit financiar. Përveç auditimit të brendshëm, institucioni realizon gjithashtu auditim të jashtëm vjetor për situatën financiare, i kryer nga një kontabilist i miratuar dhe i regjistruar. Ky audit zhvillohet mbi bazën e bilancit vjetor kalendarik, dhe raportet përgatiten në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit financiar. Raporti financiar ofron një pasqyrë të detajuar të bilancit, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit gjatë vitit përkatës. Të dy raportet – si ai i brendshëm, ashtu edhe ai i jashtëm – përmbajnë analiza mbi efikasitetin e përdorimit të të ardhurave, veçanërisht ato të gjeneruara nga tarifat e studentëve, dhe përdorimin e tyre për rritjen e cilësisë së studimeve në të gjitha ciklet e arsimit të lartë. Këto raporte paraqiten periodikisht pranë Bordit të Administrimit, duke shërbyer si bazë për marrjen e vendimeve strategjike në drejtim të përmirësimit të performancës financiare dhe cilësisë akademike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni disponon dokumentacion të plotë mbi raportet financiare për tre vitet e fundit, të cilat hartohen dhe përpunohen gjatë periudhës mars–maj të çdo viti kalendarik. Përgatitja e raportit financiar vjetor është përgjegjësi e Rektoratit, i cili e zhvillon këtë proces në përputhje me planifikimet e mëparshme të përcaktuara në programin financiar. Pas finalizimit, raporti i realizimit financiar i paraqitet Bordit të Administrimit, i cili kryen miratimin zyrtar të tij. Pas kësaj faze, realizohet gjithashtu një analizë vjetore, me qëllim identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe planifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen dhe zhvillimin e programeve të studimit në vazhdimësi.</p>
<p>Kriteri 5.Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të</p>	<p>Situata financiare dhe bankare e “Albanian University” dëshmon për një qëndrueshmëri të vazhdueshme financiare përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të këtij programi studimi. Institucioni zotëron kapacitete të mjaftueshme financiare që mundësojnë jo vetëm mbulimin e nevojave aktuale, por edhe përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës akademike, si dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, në funksion të rritjes së cilësisë së ofrimit të arsimit të lartë.</p>




përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.									
Konkluzione	<p>Bazuar në informacionin e dorëzuar, konstatohet se “Albanian University”, si pjesë e Shoqërisë “UFO” sh.p.k., gëzon një buxhet vjetor të planifikuar në përputhje me nevojat institucionale, i mbështetur në një program financiar afatmesëm trevjeçar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky program siguron mbështetjen e funksionimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të programeve të studimit.</p> <p>Planifikimi i burimeve financiare bazohet në nevojat e zhvillimit të veprimtarive akademike dhe kërkimore, duke ndjekur parime të transparencës dhe gjithëpërfshirjes. Universiteti mbështet financiarisht aktivitete akademike si konferenca shkencore dhe studentore, në funksion të promovimit të kërkimit dhe përfshirjes së stafit dhe studentëve.</p> <p>Institucioni zotëron raporte financiare të dokumentuara për tre vitet e fundit, të hartuara në periudhën mars–maj të çdo viti. Situata financiare dhe bankare dëshmon për qëndrueshmëri të vazhdueshme dhe kapacitete të mjaftueshme për mbulimin e nevojave aktuale dhe zhvillime të mëtejshme, duke garantuar cilësi të qëndrueshme në ofrimin e arsimit të lartë.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e	Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University”, rezultoi se ky i fundit zbaton politika dhe procedura ligjore të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve. Pranimi i studentëve të rinj dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>procesi i tyre akademik është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>2024-2025 9 studentë</p> <p>2023-2024 1 student</p> <p>2022-2023 8 studentë</p> <p>Institucioni zbaton politika dhe procedura të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, deri në përmbylljen e detyrimeve akademike.</p> <p><i>Evidencë nr.II.7-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimit të Studimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe dispozitat ligjore të “Albanian University” për trajtimin e studentëve, nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve, kanë si synim sigurimin e barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në programin e studimit, duke siguruar transparencë.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik “Albanian University” i referohet urdhrit të MASR në lidhje me procedurat e regjistrimit të studentëve.</p> <p>Universiteti shpall listën paraprake të fituesve për secilin program studimi, më pas atë përfundimtare.</p> <p>Kandidatët kryejnë regjistrimin përfundimtar në programin e studimit ku janë shpallur fitues duke u paraqitur me dokumentet për regjistrim</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteretparashikojnëedheregjis trimin e studentëvetëhuaj.</p>	<p>Lidhur me këte kriter, mbështetur edhe në evidencat e vëna në dispozicion, rezulton se “Albanian University” aplikon një proces transparent për pranimin e studentëve, duke publikuar kriteret dhe kuotat në faqen zyrtare para fillimit të vitit akademik. Kriteret bëhen publike në portalin e maturës shtetërore për të gjithë kandidatët. Gjithshtu, institucioni është pjesë e panairit “Work&Study” ku informon maturantët për programet e studimit të ofruara në “Albanian University”.</p> <p>Pranimi i studentëve në këtë program studimi kryhet në përputhje me ligjin dhe aktet nën ligjore në fuqi. Kriter hyrës për regjistrimin e studentëve është mesatarja e cila përcaktohet me VKM. Programi i studimit gjithashtu ka të përcaktuar kriteret e pranimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 70% mesatarja sipas VKM - 30% mesatarja e lëndëve të cilat përcaktohen çdo fillim viti me Vendim të Senatit Akademik të “Albanian University”, pas kërkesës së MASR-së <p><i>Evidencë nr. V.1 Panairi "Work&Study"</i></p> <p><i>Evidencë nr. V.2 Udhëzues orientues i maturanteve</i></p>
<p>Kriteri 4.Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të</p>	<p>Mbështetur në takimet e realizuara në “Albanian University”, rezultoi se studentët njihen paraprakisht me kriteret e pranimit, procedurat e përzgjedhjes, transferimit të studimeve apo cdo shërbim tjetër. Sipas përfaqësuesve të studentëve dhe personelit ndihmës akademik, këto</p>




<p>transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>kritere dhe procedura janë lehtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes web të universitetit si edhe sekretarisë mësimore ose njoftimit publik të afishuar në vende lehtësisht të dukshme. Kriteret e përcaktuara dhe procedurat që ndiqen janë në mbështetje të bazës ligjore. Ka implementuar mekanizma efikase për të përcjellë informacionin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit, transferimin e studimeve dhe diplomimin në faqen zyrtare</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>“Albanian University” ndjek një praktikë të zakonshme në publikimin e kriterëve dhe kërkesave për programet e studimit para fillimit të vitit akademik. Kjo përfshin një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese, duke filluar nga faqja zyrtare e “Albanian University” dhe duke përfunduar me kontakte direkte me individë dhe grupe të interesuar përmes takimeve të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet bachelor. Çdo njoftim publikohet në faqen zyrtare të “Albanian University”, duke rritur transparencën me çdo student.</p> <p>Në rregulloren mësimore të programit të studimit jepen informacione mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit.</p> <p>Në rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve jepen informacione të detajuara për njohjen e plotë ose të pjeshme të studimeve të mëparshme. Të gjitha këto informacione vihen në dispozicion të studentëve nga strukturat përkatëse, të cilat janë të disponueshme edhe për sqarime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidencë R.1 - Rregullorja e Programit të Studimit Bsc. "Anglisht"</i> <i>Evidencë nr. II.7 - Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimit të Studimeve</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/</p>
<p>Kriteri 6 .Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Mbështetur në dokumentet e miratur lidhur me parashikimin e kuotave të pranimit dhe kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marginalizuara, rezultoi se institucioni zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre. Për vitin akademik 2022 - 2023, me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 4, datë 09.03.2022, janë miratuar 4 kuota për studentë me statusin e jetimit, 3 kuota për persona me aftësi ndryshe, 1 kuotë për komunitetin rom dhe ballkano – egjiptian dhe 4 kuota për studentët që vijnë nga trojet. Përzgjedhja e kandidatëve fitues, bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme të miratuara nga “Albanian University”.</p>
<p>Kriteri 7.Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Përveç kuotave dhe kriterëve të parashikuara në kriterin 6, “Albanian University” parashikon edhe kuota dhe kriteret për përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera. Përpara fillimit të çdo viti akademik, bëhet hartimi i kriterëve të pranimit për të gjitha kategoritë e aplikantëve në “Albanian University”. Këto kriteret, miratohen me Vendim të Senatit Akademik, i përcillen për dijeni Ministrisë së Arsimit</p>




	dhe Sportit dhe publikohen në faqen zyrtare https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/ .			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	<p>Institucioni harton politika për të ndihmuar studentët që i përkasin shtresave në nevojë dhe atyre të kategorive të veçanta. Me propozim të Senatit Akademik dhe miratim të Bordit të Administrimit, përcaktohen kategoritë e studentëve, të cilët përfitojnë bursa të ndryshme studimi, ku përveç programit të ekselencës, i cili mbështetet në rezultatet e arritura nga studentët, përfshihen edhe kategori të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës; • Fëmijët jetimë e ata të rritur në institucione shtetërore; • Persona të kategorive të veçanta invaliditeti; • Studentë të komunitetit rom; <p>Studentë të propozuar nga Organizata Rinore. https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstatoi se "Albanian University" implementon një politikë të qartë dhe transparente për pranimin dhe zhvillimin akademik të studentëve, të bazuar në legjislacionin vendas dhe Statutin e institucionit. Politikat dhe dispozitat për trajtimin e studentëve janë në përputhje me ligjin dhe promovojnë barazi dhe drejtësi.</p> <p>Institucioni gjithashtu zbaton mekanizma efikase për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare, duke përdorur një game të gjerë të mjeteve komunikuese dhe bashkëpunimin me strukturat kompetente, duke treguar kujdes të vecantë lidhur me promovimin dhe ofrimin e informacioneve të duhura për aspirantët student në programet e studimit.</p> <p>"Albanian University" harton politika të veçanta për shtresat në nevojë dhe bën një shpërndarje të drejtë të kuotave për studentët e rinj, studentët që duan të transferohen, studentët që vijnë nga trojet ose studentët nga shtresat në nevojë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të	<p>Rregullorja institucionale ofron informacion për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve.</p> <p>Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, kritere dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve etj.</p>

<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University” si edhe në dokumentet e dorëzuara, rezulton se personeli akademik dhe sekretaria mësimore luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e informimit të studentit për përparimin e tij akademik.</p> <p>Studentët njihen me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh. • Studenti detyrohet të frekuentojë lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit. <p>Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Gjatë takimeve të realizuara në “Albanian University”, rezultoi se ky i fundit nëpërmjet zyrave përkatëse, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studimet e mëparshme. Këto kritere dhe procedura janë edhe të pasqyruara në rregulloren e fakultetit. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve përgjegjëse për realizimin e regjistrimeve dhe transferimeve të studimeve, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin, njeh studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Departamenti me fillimin e vitit akademik bën të mundur ngritjen e Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Anglishtes, përmes personelit akademik dhe sekretarisë mësimore informon studentët në fillim dhe gjatë vitit akademik rreth kritereve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve për çdo lëndë dhe program studimi. Ky informacion përfshin sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, kontrollin e dijeve, kushtet për hyrjen në provim, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe mundësitë për përmirësimin e notave.</p> <p>Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) dhe Këshilli Studentor, janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore jetën studentore, etj.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni I arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ pasi realizoi takimin në “Albanian University” si edhe shqyrtoi dokumentacionin e dërguar, konstatoi se Departamenti në mënyrë të vazhdueshme jep informacione të detajuara lidhur me përgatitjen e diplomës dhe procesin e diplomimit.</p> <p>Në fillim të semestrit të dytë, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Diploma “Bachelor” mund të fitohet duke dhënë një provim të përgjithshëm formimi, i cili është alternativë me mbrojtjen e një punimi diplome për studentët që kanë mesatare mbi 8.7.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni I arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Albanian University organizon takime të hapura me kandidatë për studentë dhe publikon nëpërmjet manifestit akademik, njoftimeve në rrjete sociale, faqes zyrtare, zyrave të sekretarive dhe stafit akademik, informacion që përcillet tek të interesuarit.</p> <p>Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MAS (<u>ditët e informimit</u>), dhe më pas në vazhdim për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=broshura</p> <p>GVJ vlerëson se duhet të punohet më mirë për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në këtë program.</p> <p><i>Evidencë nr. V.3-Manifesti Akademik</i> <i>Evidencë nr.V.4-Broshura “Albanian University”</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>“Albanian University” vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Anglisht, në fillim të vitit akademik, informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</p> <p>GVJ vlerëson se duhet të punohet më mirë për të rritur numrin e studentëve të regjistruar në këtë program.</p> <p><i>Studentët informohen që në hyrje për mënyrën e vlerësimit dhe udhëzohen nga njësitë përgjegjëse për kontrollin e njohurive të dijeve si dhe për mënyrën e punimit të diplomës. Studentët në programin e studimit Bachelor në "Anglisht" mund të diplomohen me provim përfundimtar ose punim diplome, dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Para fillimit të vitit akademik dhe periodikisht, “Albanian University” organizon takime për informimin e maturantëve.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët e “Albanian University” informohen mbi strukturën dhe kohëzgjatjen e studimeve në forma të ndryshme. Sekretaria mësimore, faqja ëeb si edhe personeli akademik i vijnë në ndihmë studentëve për tu informuar rreth programit apo për çdo ndryshim të nevojshëm.</p> <p>Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese (ditët orientuese), gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) dhe Këshilli Studentor janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambientet mësimore, jetën studentore, etj.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Në fillim të çdo vit akademik, kryesisht gjatë javës së parë të mësimin, studentët marrin informacion nga personeli akademik mbi programin e lëndës ku përcaktohen qartë temat dhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit, periudha e provimeve, objektivat formues, mënyra e vlerësimit etj.</p> <p>Kjo gjë është pasqyruar në RVB por u konfirmua edhe përgjatë takimeve me personelin akademik të këtij programi studimi dhe përgjatë takimeve me studentët e po këtij programi.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Në aspekt të vlerësimit të mundësive të punësimit si edhe mbështetjes institucionale të studentit, pranë “Albanian University” janë ngritur Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) që informojnë vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizojnë aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese mbështesin studentët në aplikimet e tyre, mundësojnë aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat Institucioni bashkëpunon etj. Këto struktura shërbejnë si urë lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës</p> <p>Studentët përfitojnë gjithashtu nga programi i nxitjes së punësimit.</p> <p><i>Evidencë nr. V.5 - Panairi i punës në “Albanian University”</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Njësia bazë ofron për studentët informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me strukturën mësimore, planin mësimor, orarin e mësimave, kalendarët e provimeve, dhe njoftimet përmes disa kanaleve, duke përfshirë sekretarinë <i>online</i>, Sistemin Pitagora, klasat Microsoft Teams dhe në faqen e tij <i>ë eb</i>, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/kreu/ <i>Evidencë nr. V.6 - Rregullore për publikim Faqa ëeb</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ konstaton se informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë për studentët përmes disa kanaleve, duke përfshirë faqen zyrtare të universitetit, postën zyrtare elektronike dhe sistemin e sekretarisë mësimore. Studentët e programit të studimit bachelor në Anglisht, aksesojnë sistemin PITAGORA përmes aksesit që ato kanë në email e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Qasja e studentëve në mësim mund të realizohet edhe nëpërmjet sistemit Microsoft Teams si edhe njoftimeve në rrjetet sociale</p> <p>(ëëë.albanianuniversity.edu.al)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se nëpërmjet faqes web të “Albanian University”, studentit mund të gjejë informacionin e dëshiruar. Ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë. Sekretaria mësimore dhe personeli akademik i vijjnë në ndihmë studentëve për tu informuar rreth programit apo për çdo ndryshim të nevojshëm. Studentët informohen përmes rregulloreve të institucionit dhe programit, duke përfshirë njohjen me lëndët, planin mësimor dhe aktivitetet formuese. Njësia Bazë siguron informacion lidhur me strukturën mësimore dhe njoftimet përmes kanaleve të ndryshme. Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm për studentët në distancë përmes faqes zyrtare, postës elektronike dhe sistemit të sekretarisë mësimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban</p>	<p>“Albanian University” mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në këtë program studimi. Në</p>




<p>statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>sekretarinë mësimore ruhet dokumentacioni i procesit mësimor konkretisht regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Gjithashtu GVJ u informua se “Albanian University” gjurmon studentët e diplomuar dhe harton një listë mbi punësimin e tyre ose gjendjen e tyre aktuale në momentin e komunikimit. Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.</p> <p><i>Evidencë-Tabela 23</i></p>
<p>Kriteri 2.Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet program I studimeve.</p>	<p>Të dhënat e parashikuara në këtë kriter përpunohen dhe ruhen në të dy formatet, si atë elektronik edhe në atë fizik. Njësia bazë ka në dispozicion statistika vjetore të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, dhe diplomimin e tyre. Të dhëna mbahen edhe për studentët që çregjistrohen nga programi.</p>
<p>Kriteri 3.Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e “Albanian University”torizuar.</p>	<p>Përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit elektronik PITAGORA, “Albanian University” menaxhon të dhënat statistikore të studentëve. Të dhënat janë lehtësisht të gjatshme për personat e “Albanian University”torizuar.</p> <p>Të dhënat e studentëve ruhen mbi bazën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;</p> <p><i>Evidencë nr.VI.17 - Raport vjetor Institucional v.a 2023-2024</i></p>
<p>Kriteri 4.Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodic të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe esaktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>“Albanian University” në aktet e brendshme përcakton mundësinë për ushtrimin e kontroleve periodike pranë njësive përgjegjëse për menaxhimin:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rektori ushtron kontrole tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të “Albanian University”; 2. Gjithashtu, në mbështetje të nenit 80, të Statutit të “Albanian University” funksionon edhe Zyra e Kontrollit dhe “Albanian University”ditit të Brendshëm . <p>Në mbështetje të Rregullores së Sekretarisë Mësimore, se në përfundim të çdo semestri, Kryesekretari i Fakultetit përgatit dhe dorëzon pranë Dekanit dhe Rektorit, një raport të veçantë me të dhëna të detajuara mbi realizimin e detyrave të fushave që mbulon.</p>





	Këto struktura vlerësojnë dhe dokumentojnë gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre përkatëse			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia kryesore dhe njësia bazë hartojnë raporte të përvitshme në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Njësia bazë në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallën e punësimit të tyre. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim me kërkesë të saj. Sekretaria mësimore në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit si dhe Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes janë të përfshirë në procesin e krijimit të raporteve analitike mbi profilet e studentëve të ardhur dhe aktualë dhe shkallën e punësimit të tyre. <i>Evidencë nr. 1.12 -Raporti ZKKSHBA</i>			
Konkluzione	<i>Lidhur me cilësinë në hyrje dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi, GVJ konfirmon se “Albanian University” e përmbush këtë standard plotësisht. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen dhe ruhen në mënyrë konfidenciale. Ky informacion mund të jetë i aksesueshëm vetëm për persona të autorizuar duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Zyra Alumni mban evidenca lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar pranë këtij universiteti. Megjithatë sugjerohet që zyra Alumni të bëjë një përditësim të tabelës statistikore mbi të dhënat e punësimit të studentëve duke specifikuar edhe profilin në të cilin janë punësuar pas përfundimit të studimeve. Këto raporte integrohen në dokumentacionin më të gjerë të “Albanian University” dhe duke përfshirë raportet e Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Zyrës së Alumni etj. Ky proces monitoron dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga “Albanian University”, duke prezantuar rezultatet në raporte periodike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Kuadri ligjor për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tonë përcakton në një nen të veçantë të drejtën e studentëve për tu organizuar në Këshilla Studentorë, si organizime të pavarura që përfaqësojnë interesat e tyre. (Evidenca Ligji Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 59, Këshillat e Studentëve).</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Studentët përfaqësohen në vendimmarrje në organet e “Albanian University” përmes përfaqësuesit të tyre të zgjedhur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senatin Akademik - Këshillin Studentor - Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin - Komisionin për Vlerësimin Institucional Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. <p><i>Evidencë-Ligji Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 59, Këshillat e Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë nr. V.7 7- Rregullore e Këshillit Studentor</i></p>
<p>Kriteri 2.Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Mbështetur në takimet e realizuara me studentët në “Albanian University”, rezultoi se “Albanian University” garanton përfshirjen e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p>Duke iu referuar Statutit të Institucionit neni 47 “Të drejtat e studentëve”, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në vendimmarrje, këshillime apo vlerësim e në procesin akademik.</p> <p>Studentët janë pjesë e disa komisioneve në të cilat japin kontributin e tyre si komisioni ad-hoc për zhvillimin e planprogrameve, komisionet e zhvillimit të strategjive dhe prioriteteve në nivelin e njësisë bazë etj.</p>
<p>Kriteri 3.Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>“Albanian University”, në përputhje me Statutin dhe aktet rregulluese, inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe vlerësuese. Studentët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë planet dhe programet e studimeve, cilësinë e shërbimeve, tarifën, dhe kontribute financiare.</p> <p>Në bazë të nenit 25 të Statutit të “Albanian University” për Komisionet e Përhershme, studentët kanë përfaqësimin e tyre në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisioni për Vlerësimin Institucional dhe Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Në këtë mënyrë me anë të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre, ata bëhen pjesën e vendimmarrjeve në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit</p> <p>DEA përfshin studentët në vendimmarrje të ndryshme si dhe në përmirësimin e programit të studimit, në mbledhje të ndryshme të organizuara, në aktivitete me karakter vendimmarrje etj.</p> <p>Evidenca-Vendimin Nr.301/1 Prot, datë 08.05.2025 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore “Mbi miratimin e Grupit të punës për vlerësimin e brendshëm për Akreditimin e programit të studimi Bachelor në Anglisht.</p>





<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ u njoh gjatë vizitës në “Albanian University” edhe me procedurën që ky universitet ndjek në rast se studenti i programit të studimit Bachelor në Anglisht nuk është i kënaqur me vlerësimin në një lëndë të caktuar. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve.</p> <p>Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lartë, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korigjuar provimet.</p> <p>Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit (fletës së provimit).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>“Albanian University” inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në organet kolegjiale dhe proceset vendimmarrëse duke i përfshirë në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, komisionet zgjedhore dhe vlerësuese, si dhe Këshillin Studentor. Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e tyre në çështjet akademike dhe administrative, duke u mundësuar të shprehen në lidhje me planet e studimit, cilësinë e shërbimeve, tarifat dhe kontributet financiare. Për sa i përket procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ato realizohen me shumë korrektesë nga pedagogët e lëndëve përkatëse duke iu përmbajtur një procesi shumë transparent ndaj studentëve, gjë që e konstatuam edhe nga vetë deklaratimet e këtyre të fundit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p align="center">Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësitë posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Studentët në këtë program studimi, por edhe në rang Fakulteti informohen dhe asistohen lidhur me problematika apo orientime të programit të studimit.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit janë dy njësitë kryesore në shërbim të informimit të studentëve, krahas Departamentit dhe Sekretarisë mësimore.</p>




	<p><i>Evidencë nr. V.8 - Rregullore Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët</i></p> <p><i>Evidencë nr. V.9 - Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një system të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët në “Albanian University”, GVJ vuri re se njësia bazë jep një ndihmë shumë të madhe në asistimin e studentëve për problematika të ndryshme që mund të hasin gjatë vitit akademik .Studentët informohen, këshillohen, ndiqen dhe informohen nëpërmjet disa burimeve në “Albanian University”.</p> <p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara, nën përgjegjësinë e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në bashkëpunim të ngushtë me departamentin, dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p> <p><i>Evidencë nr. V.9 9 - Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët. Ata sigurojnë informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin. Gjithashtu, ndihmojnë studentët që kanë përfunduar studimet në nivelin e parë për të gjetur mundësi për vazhdim të studimeve ose për punësim. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin e praktikave profesionale, duke ofruar trajnime dhe shërbime të tjera të përmirësuara për zhvillimin e studentëve.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Departamenti me mbështetjen e ZKA orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit, pranë të cilit do të zhvillojnë praktikën mësimore. Praktikën mësimore zhvillohen kryesisht në institucionet me të cilat “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Tabela 5</i></p> <p><i>Evidencë nr. V.11 Udhëzuesi i Karrierës</i></p> <p><i>Evidencë nr. V.10 Aktivitete ekstrakurrikulare</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e “Albanian University”toriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Studentët ALUMNI janë ndjekur në vazhdimësi nga Departamenti për progresin e tyre në profesion dhe karrierë edhe pas diplomimit. Nga të dhënat e dokumentuara, por edhe nga vizita e GVJ u konstatua se Zyra e Zhvillimit dhe Karrierës disponon një bazë të dhënash të përditësuar mbi punësimin e të diplomuarve ndër vite apo të dhëna mbi studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme.</p> <p>Studentët të cilët përfundojnë studimet e tyre pranë programit Master Profesional në Pedagogji me profil 1. “Mësuesi në Arsim Fillor” dhe 2. “Menaxhim Arsimi” janë Alumni i tij. Zyra e Karrierës dhe Alumnit kujdeset në mënyrë periodike për krijimin e një databazë statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në “Albanian University.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit i ndihmon ish-studentët përmes:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> - Dhënies së referencave për studime dhe punësim, - Angazhimit në projektet e universitetit, veçanërisht në studime dhe projekte të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike; - Publikimit të punimeve shkencore të studentëve të diplomuar (Alumni-t) në Revistën shkencore. <p><i>Evidencë nr.12 Statistika të punësimit të studentëve</i></p>			
konkluzione	<p><i>GVJ gjatë takimeve me grupet e studentëve dhe përfaqësuesve të zyrës së këshillimit të karrierës vuri re një impenjim të "Albanian University" për t'i ndihmuar studentët të gjejnë veten në tregun e punës dhe duke i orjentuar ata drejt mundësive të punësimit, si në sektorin publik edhe në atë privat</i></p> <p><i>Bashkëpunimi i ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore, si dhe përdorimi i rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të universitetit, shërbejnë për të siguruar një përkrahje të efektshme për zhvillimin e studentëve në aspektin mësimor. Zyra e Alumni, ndjek studentët pas diplomimit, ofron informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin, ndihmon studentët për vazhdimin e studimeve apo punësimit, dhe mbledh të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të diplomuarve të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>"Albanian University" ofron udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes operon mbi një strukturë akademike, e cila përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e shoqërisë dhe evolucionin e formave të reja të komunikimit.</p> <p>Pedagogët e angazhuar pranë Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes përdorin platformën Microsoft Teams, pjesë e paketës Office 365, të mundësuar nga Institucioni, për të vënë në dispozicion të studentëve</p>




	<p>materialet mësimore. Gjatë periudhës së pandemisë Covid – 19 dhe në vazhdim, Institucioni ka zhvilluar trajnime të ndryshme për përdorimin e instrumenteve informatikë në funksion të mësimdhënies dhe ka përgatitur udhëzues, të cilët janë vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr. VI. 1 Klasat në teams</i> <i>Evidencë nr. VI. 2 Manual për mësimin Online M.Teams</i></p>
<p>Kriteri 2.Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, referuar akteve ligjore e nënligjore në fuqi si dhe akteve të brendshme, përmes strukturave përkatëse: Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë, monitoron në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve semestrale të studentëve dhe raporteve semestrale të vetë pedagogëve.</p> <p><i>Evidencë nr. I.5 Rregullore e përgjithshme e "Albanian University"</i> <i>Evidencë nr. IV.3 Procedura e rekrutimit të stafit</i> <i>Evidencë nr.III.12. Axhenda e javës orientuese</i></p>
<p>Kriteri 3.Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodic të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>"Albanian University" sipas Statutit, përfshin studentët në vlerësimin periodic të mësimdhënies dhe dijeve. Studentët monitorojnë përgatitjen e tyre dhe ndikojnë në cilësinë e shërbimeve. Njësia Kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) zhvillon pyetësorë për dobësitë në mësimdhënie dhe performancën e stafit akademik, me rezultatet të diskutuara në mbledhjet e Departamentit.</p> <p>Në fund të çdo semestri, përpara sezoneve të provimeve, studentëve ju vihen në dispozicion pyetësorët për vlerësimin e stafit akademik dhe administrativ. Gjatë vitit të fundit akademik, ky pyetësor është realizuar në Microsoft Forms.</p> <p><i>Evidencë nr. VI. 3. Model pyetësori studenti - M.Teams</i></p>
<p>Kriteri 4.Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti u referohet kriterëve dhe objektivave të përcaktuara periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së institucionit (NJSBC). Monitorimi dhe siguri i cilësisë në "Albanian University" zhvillohet përmes aplikimit të vazhdueshëm të mjeteve analitike si anketat, sondazhet dhe sesionet e informimit, të cilat mbledhin të dhëna të rëndësishme për përmirësim institucional.</p> <p>Të dhënat pasi përpunohen nga NJSBC, i vihen në dispozicion Departamentit, i cili i diskuton në tërësi në mbledhjen e radhës. Rastet specifike, apo shqetësuese, diskutohen personalisht me personat e interesuar. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes emailit dhe në Departament.</p>




	<i>Evidencë nr. VI. 4. Raport Vjetor NJSBC v.a 2023-2024</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson si një praktikë të mirë periodicitetin e raporteve vjetore institucionale dhe të njësisë bazë, të cilat përmbajnë ndër të tjera edhe elementë që lidhen me mësimdhënien apo kërkimin shkencor. Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësie bazë, ka qëllim të promovojë praktikat e mira, të nxisë vazhdimësinë e tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.			
Konkluzione	<i>“Albanian University” shfaq një qasje progresive dhe angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë. Me udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale, institucioni promovon praktika të mira në mësimdhënie. “Albanian University” tregon një angazhim të vazhdueshëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, përfshirë përdorimin e mekanizmave të vlerësimit dhe analizave të rezultateve. Gjithashtu, “Albanian University” ndjek një qasje të strukturuar dhe transparente për cilësinë nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka synim për një përjasje të vëmendshme ndaj sugjerimeve dhe propozimeve për ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si edhe në statutin e “Albanian University”, Senati Akademik ka miratuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në “Albanian University”, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Puna e NJSBC-së duhet të realizohet bazuar në një planifikim vjetor, i cili i përgjigjet edhe politikave të institucionit, parashikuar në statutin e tij (misioni dhe vizioni). “Albanian University” për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika në nivel institucional, si dhe ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet




	<p>përdorimit të instrumenteve të duhura. Strukturat e ngritura dhe procedurat e ndjekura janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.</p> <p><i>Evidencë nr. VI. 5- Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në “Albanian University”</i> <i>Evidencë nr. VI. 6- Rregullore e Komisionit Institucional</i> <i>Evidencë nr. VI. 7- Manual për Sigurimin e Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23.07.2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22.12.2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional pjesë e të cilit është edhe një student. Studentët, gjithashtu, janë të përfshirë si pjesë e grupit të punës në çdo rast kur institucioni realizon akreditimin institucional apo akreditimin e programeve të studimit, si dhe gjatë realizimit të pyetësorëve. Prej shtatorit të vitit 2016, në mbështetje të cilësisë në “Albanian University”, funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08.09.2016, anëtarët e të cilëve ndryshojnë çdo vit. NJSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.</p> <p><i>Evidencë nr. VI.8 Vendim Senati Akademik "Krijimi i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" - 23.07.2010</i> <i>Evidencë nr. VI.11.a,b Miratimi i propozimit të Bordit të Administrimit - konsulente juridike prane NJSBC Dr. Proc. Entjola Pano; - Vendim i Bordit të Administrimit - konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave Prof. Asoc. Dr. Bedri Kola</i> <i>Evidencë nr. VI. 9. Vendim Senati Akademik "Krijimi i Komisionit per Vlerësimin Institucional" - 22.12.2016</i> <i>Evidencë nr. VI.10.a,b,c,d,e.-Konfirmim i pedagogëve përgjegjës per Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2020 – 2021/22/23/24/25</i> <i>Evidencë nr. VI. 5. Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në “Albanian University”</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera</p>	<p>“Albanian University” në kuadër të sigurimit të cilësisë i kushton rëndësi rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë në fushën përkatëse. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Realizohen trajnime me personelin akademik, edhe me lektorë të huaj, për çështje që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. Instrumentet e shumta, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një <i>feedback</i>-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Institucioni në mënyrë periodike, në bashkëpunim me ASCAL realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit.</p>




që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	<i>Evidencë nr. III.a.b.c.d.</i> <i>a. Raport semestral DEA</i> <i>b. Orët e hapura</i> <i>c. Axhenda e trajnimeve stafi akademik v.a 2020-2025</i> <i>d. Rregullore e ZKKSHBA</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit parashikohet në strategjinë e zhvillimit institucional si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit. Njësia kryesore, FSHSH dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes hartojnë një raport semestral dhe një raport vjetor njësie kryesore në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. Studentët përmes pyetësorëve kanë mundësinë të shprehen për mbarëvajtjen e programit të studimit, burimet e të nxënit, cilësinë e mësimdhënies, kontrollin e njohurive, metodologjinë e pedagogut të lëndës dhe ndjekjen e studentëve me detyrat e kursit dhe gjithë detyrimet e lëndëve. Pyetësori zhvillohet në kushtet e anonimatit të plotë dhe pa praninë e stafit akademik. <i>Evidencë nr. I. 2-Plani Strategjik Institucional 2023-2028</i> <i>Evidencë nr.VI.5 Rregullore e Komisionit Institucional</i> <i>Evidencë nr. III.1 Raport semestral DEA</i> <i>Evidencë nr.VI. 12 Raport vjetor FSHSH</i>			
Konkluzione	<i>"Albanian University" në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 ka vendosur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NJSBC duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, ndjekin një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Bashkëpunimi me institucione të tjera kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e bashkëpunimit.</i>			
Shkalla e përbushjessëstandardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të	Institucioni zbaton mekanizma dhe procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit të ciklit të parë. Njësitë bazë dorëzojnë raportet vjetore të veprimtarisë, aktivitetëve të brendshme dhe gjithashtu tërësinë e angazhimeve të personelit akademik kryesisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>në aktivitete artistike, botime, pjesëmarrje konferencash, marrëveshje bashkëpunimi, projekte kërkimore shkencore dhe mobilitete.</p> <p>“Albanian University” angazhon Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti. Këto janë grupe <i>ad-hoc</i>, të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Në këtë proces AU realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura njesive pwrkatese.</p> <p><i>Evidencë nr.VI.10.a - Konfirmim i pedagogëve përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2020 - 2021</i> <i>Evidencë nr.VI.10.b - Konfirmim i pedagogëve përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2021 - 2022</i> <i>Evidencë nr.VI.10.c - Konfirmim i pedagogëve përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2022 - 2023</i> <i>Evidencë nr.VI.10.d - Konfirmim i pedagogëve përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2023 - 2024</i> <i>Evidencë nr.VI.10.e - Konfirmim i pedagogëve përgjegjës për Sigurimin e Cilësisë në nivel Departamenti - v.a. 2024 - 2025</i></p>
<p>Kriteri 2.</p> <p>Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Referuar RVB por edhe dokumentacionit të ofruar konstatohet se procesi i sigurimit të cilësisë në “Albanian University” fillon nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Njësia Bazë harton raportin vjetor duke vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha programet që ofron. Ky raport i përcillet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Njësisë Kryesore përkatëse, e cila këtë informacion e përfshin në raportin vjetor të saj. Në raportet vjetore përfshihen edhe të dhëna mbi masat e marra nga plan veprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. Rezultatet e vlerësimeve të realizuara nga NJSBC dokumentohen në formë shkresore dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse. Të gjitha të dhënat e mbledhura në mënyrë periodike gjatë vitit akademik pasqyrohen në raportet vjetore duke filluar nga Njësia Bazë e duke vazhduar deri në Senati nAkademik dhe Bordin e Administrimit për t’u dërguar më pas në MASR, si dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Institucionit.</p> <p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Lidhur me këtë kriter, GVJ konstatoi se vlerësimi i cilësisë së programit Bachelor në Anglisht sigurohet nëpërmjet cilësisë së mësimdhënies si edhe numrit të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësisë së materialeve mësimore dhe infrastrukturës. “Albanian University” për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta si më poshtë:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit) ▪ Fokus grupe (në muajin Janar), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. ▪ Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve ▪ Raporte të vetëvlerësimit (2 herë në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik) ▪ Te drejtpërdrejta ▪ Vëzhgime në “Albanian University” ditore, gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. <ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjatë periudhës së Covid – 19, janë zhvilluar pyetësorë lidhur me cilësinë e mësimit <i>online</i> dhe realizimin e komunikimit në distancë drejtuar studentëve, stafit akademik dhe administrativ <p><i>Evidencë nr.III.10 Raporti i vlerësimit të stafit akademik</i> <i>Evidencë nr. VI.9 Vendim Senati Akademik "Krijimi i Komisionit për Vlerësimin Institucional" - 22.12.2016</i> <i>Evidencë nr. VI. 13 a- Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2020 - 2021</i> <i>Evidencë nr.VI.13.b - Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021</i> <i>Evidencë nr. III.9 Raport vetëvlerësimi i programit të studimit</i> <i>Evidencë nr.III.12 Axhenda e javës orientuese</i> <i>Evidencë nr. III.1 Raport semestral DEA</i></p>
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të</p>	<p>GVJ konstatoi se “Albanian University”zhvillon takime informuese dhe trajnuese me qëllim vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Anglisht. Njësia bazë përdor pyetësorë, teste dhe sondazhe për vlerësim, duke synuar matjen e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Këto metoda sigurojnë një analizë të detajuar të performancës së programit në përputhje me nevojat e studentëve dhe standardet e përcaktuara.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, është zhvilluar një pyetësor mbi “Lumturinë në punë” drejtuar stafit akademik dhe administrativ të Universitetit.</p>




tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e "Albanian University". <i>Evidencë nr. VI. 14-Pyetësori mbi "Lumturinë në punë"</i>			
Konkluzione	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se "Albanian University" ka ngritur struktura të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e programit të studimit në mënyrë periodike, Raportet janë të detajuara duke përfshirë strategji efikase për përmbushjen sa më mirë të standarteve të cilësisë së mësimdhënies. Ruajtja e marrëdhënieve me studentët ALUMNI dhe mundësia e angazhimit të tyre në institucion me veprimtari të ndryshme, siguron një qëndrueshmëri të programit të studimit në tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në takimet e zhvilluara në "Albanian University" me studentët, përgjegjësin e departamentit dhe personelin akademik, GVJ konstatoi se njësia bazë e konsideron të rëndësishëm angazhimin e studentëve si edhe partnerëve në tregun e punës. Nga përgjigjet e të dy palëve u vu re se studentët ndihen të përfaqësuar. Gjithashtu në takime u theksua edhe rëndësia e partnerëve të tretë të cilët janë një urë lidhëse mes universitetit dhe tregut të punës. Institucioni në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë bashkëpunon ngushtë edhe me ekspertë të jashtëm, kryesisht nga institucionet me të cilat Njësia bazë ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi. <i>Evidencë nr. I.7- Konferencat Studentore</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe pale të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit	Institucioni promovon rolin e individëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Këto struktura bashkë me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm janë përgjegjëse për të ndjekur procesin e sigurimit të cilësisë institucionale. Në rregulloren e NJSBC janë të parashikuara detyrat e palëve të përfshira në çështjet e cilësisë.

dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<i>Evidencë nr. VI. 15 Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Institucioni thekson rëndësinë e rolit të individëve dhe studentëve në sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University” si edhe në dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se personeli akademik dhe administrativ respekton integritetin akademik, lirinë dhe etikën akademike si edhe është i kujdesshëm për të shmangur çdo formë diskriminimi apo pabarazie kundrejt studentëve apo vetë personelit. Institucioni siguron një mjedis të barabartë për të gjithë anëtarët e komunitetit universitar, pa raste të evidentuara të diskriminimit. Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të “Albanian University” . <i>Evidencë nr.VI.16 -Kodi i Etikës</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University”, GVJ konstatoi se njësia bazë merr pjesë në aktivitete promovuese dhe se vazhdimisht është në kontakt dhe bashkëpunon jo vetëm me maturantët dhe studentët por edhe me aktorë të tretë. Në këtë mënyrë, njësia bazë arrin të përmirësojë cilësinë e programit dhe u vjen në ndihmë studentëve për të patur një qasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për të shfrytëzuar mundësi punësimi apo internship-i. Një vëmendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm. Në fazën e rishikimit të programeve të studimit, Institucioni angazhon edhe ekspertë të jashtëm.
Konkluzione	<i>Mbështetur në sa më sipër, GVJ thekson rëndësinë e bashkëpunimit me aktorët e tretë si edhe me vetë studentët si element të rëndësishëm të garantimit të një programi studimi sa më cilësor. Njësia bazë ka politika të brendshme për cilësi, përfshirë aktorë të jashtëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Institucioni vlerëson rolin e individëve dhe studentëve për cilësi, ndërsa Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University” si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se universiteti ka hartuar rregullore të posaçme për sigurimin e brendshëm e cilësisë, raporte dhe analiza vjetore për të pasqyruar këtë veprimtari, plane strategjike të punës, mekanizma kontrolluese dhe monitoruese të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. “Albanian University” në përfundim të çdo viti akademik në perputhje me udhëzimin Nr. 5 dt. 18.02.2018, dërgon pranë MAS raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen <i>ëeb</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/
Kriteri 2. Institucioni I arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	“Albanian University”, në përputhje me parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale, respekton këto vlera në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit. Raportet publikohen në respekt të anonimitetit dhe të përgjithësuara në fokus të rezultateve të analizave të pyetësorëve. Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike. <i>Evidencë nr.VI. 17 Raport vjetor Institucional v.a 2023-2024</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raportet e vlerësimit trajtojnë pikat e forta dhe të dobëta, duke hartuar detyra dhe afate për përmirësim. Ky proces synon të rrisë cilësinë akademike në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me standartet më të larta të përcaktuara. Raporti vjetor i departamentit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimtari për vitin e ardhshëm akademik
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të	Mbështetur në takimet e zhvilluara në “Albanian University” si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se hartimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm, është një indikator i vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, për programin e studimit Bachelor në Anglisht. Qëllimi i hartimit të këtyre raporteve është evidentimi i problematikave dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.




cilësisë së programit të studimit.				
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afat gjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti zbaton veprimtari periodike, përfshirë sondazhe, anketime, dhe plotësimin e formularëve të kontrollit. Këto aktivitete janë pjesë e një strategjie afatgjatë për sigurimin e cilësisë në programet e studimit dhe zhvillimin e tyre. Përmes fushatave informuese, personeli akademik dhe studentët ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe inkurajohen të marrin pjesë aktivisht. Në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, studentët dhe stafin akademik informohen mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.			
konkluzione	<i>NJBSC dhe njësia bazë, bashkëpunojnë në hartimin e planit vjetor të punës, në hartimin e pyetësorëve për studentët si edhe në zhvillimin e procedurave të tjera të parashikuara në bazën ligjore si të domosdoshme për garantimin e një cilësie më të mirë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në :“Anglisht”.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi është ndërtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përmban elementë kombëtarë e bashkëkohorë, duke synuar ruajtjen e vlerave kulturore dhe përgatitjen e profesionistëve për një treg pune dinamik dhe ndërkombëtar. (Standardi I.1, kriteri 1,2,3)
2. Plani mësimor, syllabuset dhe literatura janë hartuar sipas standardeve moderne të arsimit të lartë, duke garantuar cilësi dhe përmbajtje të përditësuar. (Standardi 2.1, Kriteri 3)
3. Programi mbështetet nga staf me përvojë të gjerë në mësimdhënie dhe me kualifikime të fituara brenda dhe jashtë vendit. (Standardi I.1, kriteri 4 ; Standardi 2.2, kriteri 1.2; Standardi III.1 , Kriteri 2 dhe 4 , Standardi IV.2,Kriteri 1 dhe 2)
4. Programi siguron balancë të mirë mes njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke përgatitur studentët në mënyrë gjithëpërfshirëse për tregun e punës.(Standardi 2.1, Kriteri 1,2,3; Standardi II.3, Kriteri 1,2)
5. Janë siguruar kushte të favorshme për zhvillimin e mësimdhënies dhe aktiviteteve akademike.(Standardi IV.2 , kriteri 2)
6. Studentët janë të përfshirë në strukturat institucionale dhe vendimmarrëse, duke kontribuar në përmirësimin e procesit akademik dhe administrativ. (Standardi II.5, kriteri 2 ; Standardi V.5 , Kriteri 1)

Pikat e dobëta:

1. Regjistrimi i kufizuar ndikon në funksionimin optimal të programit dhe rrit vështirësitë në menaxhimin efikas të burimeve.(Standardi V.2., Kriteri 5)
2. Mungesa e librave fizikë bazë dhe të specializuar për programin kufizon mbështetjen akademike dhe ndikojnë negativisht në procesin e të nxënit.(Standardi IV.3, Kriteri 4, Kriteri 8)

Rekomandime:

1. Hapja e një programi Master në vijim të këtij programi Bachelor do të mundësonte vazhdimësinë akademike brenda institucionit dhe do të kontribuonte në rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ofertës akademike.
2. Për të rritur vizibilitetin e programit kërkohet ndërmarrja e analizave të rregullta dhe fushatave të promovimit për të rritur ndërgjegjësimin mbi vlerat e programit dhe për të nxitur interesin e studentëve të rinj në regjistrimet e ardhshme.
3. Është i nevojshëm zgjerimi dhe përmirësimi i bazës së literaturës mësimore, përmes shtimit të titujve bashkëkohorë dhe të specializuar në bibliotekë, në mënyrë që të sigurohet një proces mësimor cilësor dhe në përputhje me standardet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare.



4. Mos zhvillimi i një programi Master në këtë fushë brenda institucionit kufizon vazhdimësinë akademike të studentëve që dëshirojnë të thellojnë studimet.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "English Language"

Strengths and affirmations:

1. The program is developed in accordance with the legislation in force and incorporates both national and contemporary elements, aiming to preserve cultural values while preparing professionals for a dynamic and international labor market. (Standard I.1, criteria 1,2,3)
2. The curriculum, syllabi, and literature are designed in line with modern higher education standards, ensuring quality and up-to-date content. (Standard 2.1, criterion 3)
3. The program is supported by academic staff with extensive teaching experience and qualifications obtained both domestically and abroad. (Standard I.1, criterion 4 ; Standard 2.2, criteria 1.2; Standard III.1 , criteria 2 & 4 , Standard IV.2 , criteria 1 & 2)
- 4 .The program provides a well-balanced combination of theoretical knowledge and practical skills, comprehensively preparing students for the labor market. (Standard 2.1, criteria 1,2,3; Standard II.3, criteria 1,2)
5. Favorable conditions are offered for the development of teaching and academic activities. (Standard IV. 2, criterion 2)
6. Students are actively involved in institutional and decision-making structures, contributing to the enhancement of academic and administrative processes. (Standard II.5, criterion 2; Standard V.5, criterion 1)

Weaknesses:

1. Limited enrollment affects the optimal functioning of the program and creates challenges for the efficient management of resources. (Standard V.2., criterion 5)
2. The insufficient availability of basic and specialized physical books for the program restricts academic support and has a negative impact on the learning process. (Standard IV.3, criteria 4, 8)

Recommendations:

1. The opening of a Master's program following this Bachelor's program would ensure academic continuity within the institution and contribute to enhancing the quality and sustainability of the academic offer.



2. To increase the visibility of the program, it is necessary to carry out regular analyses and promotional campaigns to raise awareness of its value and to stimulate the interest of prospective students for future enrollments.
3. It is essential to expand and enrich the teaching literature base by adding contemporary and specialized titles to the library, thereby ensuring a high-quality teaching process aligned with national and international academic staff
- 4 .The absence of a Master's program in this field within the institution limits academic continuity for students who wish to further their studies.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk plotësohet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X